

## Zhbërja e progresit?

### Këmbimi i demokracisë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit

## Analizë Politike e DPC

nga Bodo Weber

Berlin  
Nëntor, 2015

**Raport nga  
Këshilli për Politika të Demokratizimit**

**Autor: Bodo Weber**

**Përkthim: Avantida**

**Redaktuar nga: Bordi Editorial i Këshillit**

**Berlin**

**Nëntor, 2015**



*Përgatitja e këtij raporti është mundësuar me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund.  
Pikëpamjet dhe qëndrimet janë të autorëve dhe jo domosmërisht pasqyrojnë  
qëndrimet e Rockefeller Brothers Fund.*

## TABLE OF CONTENTS

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE .....	I
HYRJE.....	1
SHTETËSIA E HENDIKEPUAR DHE PATERNALIZMI PERËNDIMOR .....	3
PROCESI I DIALOGUT – KËMBIMI I DEMOKRACISË DHE SUNDIMIT TË LIGJIT ME ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE RRETH STATUSIT.....	5
<i>Ligji për Amnisti</i> .....	6
<i>Tërheqja graduale e EULEX dhe krijimi i Gjykatës Speciale</i> .....	8
<i>Kriza e vitit 2014 për formimin e Qeverisë</i> .....	10
SHPËRBËRJA E STRUKTURAVE PARALELE – ÇËSHTJA E DEMOKRACISË .....	13
Përfshirja e Serbëve në strukturat e shtetit – <i>zgjedhjet lokale dhe parlamentare të viteve 2013-2014</i> .....	13
Marrëveshja e Brukselit dhe Asociacioni/Bashkësia e Komunave Serbe .....	15
KËMBIMI I DEMOKRACISË ME ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE RRETH STATUSIT – NDIKIMI .....	17
KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET .....	21

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

Në Nëntor të vitit 2014, Perëndimi nën drejtimin e Berlinit dhe Brukselit ndihmuan në arritjen e marrëveshjes së koalicionit në mes të dy subjekteve më të mëdha politike në Kosovë, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Kjo marrëveshje i dha fund bllokadës pesë mujore, e cila erdhi si rezultat i rreshtimit të LDK në koalicionin LAN me partitë opozitare, pas zgjedhjeve parlamentare të Qershorit. LAN kishte siguruar shumicën parlamentare të nevojshme për krijimin e Qeverisë, por funksionalizimi i koalicionit qeverisës u pamundësua nga dy vendime shumë kontroverze të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të cilat sipas të gjitha informacioneve të disponueshme ishin marrë nën presion të fuqishëm politik, nga partia deri atëherë në pushtet PDK. Në pranverë të vitit 2011, Perëndimi, nën drejtimin e SHBA-ve dhe me ashpërsi më të madhe se në vitin 2014, kishte ndërmjetësuar marrëveshjen mes PDK dhe LDK, duke i dhënë kështu fund krizës institucionale, e cila i mundësoi PDK që të mbetet në pushtet. Në kuadër të marrëveshjes Kuvendi kishte zgjedhur Atifete Jahjagën si kandidat të përkohshëm për postin e Presidentit. Por reformat të cilat synonin të adresonin defektet e sistemit zgjedhor, dhe instalimin e një sistemi gjysmë presidencial të qeverisjes nuk u realizuan, me gjithë faktin që ishin pjesë e marrëveshjes. Qeveria e drejtuar nga PDK dhe Presidentja vazhduan punën deri në fund të mandatit të plotë. Ajo çfarë e lidhë performancën e BE-së dhe SHBA-ve në këto dy raste janë zhvillimet e verës së vitit 2011. Në atë kohë, shpërthyen përplasjet e dhunshme në mes të Serbëve, Policisë së Kosovës, dhe KFOR-it në pjesën veriore të vendit të dominuar nga popullsia serbe. Si përgjigje ndaj eskalimit të situatës dhe dhunës, BE-ja në udhëheqjen e Gjermanisë, dhe me mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-ve, u bë faktor i rëndësishëm në përcaktimin e politikave. Si rezultat, BE mori rolin e ndërmjetësuesit në dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës.

Nënshkrimi i marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë në Prill të vitit 2013, duket se arriti të bindë BE-së dhe SHBA-të se dialogu duhet të jetë prioriteti kryesor, duke i lënë kështu në rend të dytë çështjet që ndërlidhen me demokratizimin dhe sundimin e ligjit. Përderisa mund të ketë qenë e nevojshme që dialogu të vihet në rend të parë për një periudhë të caktuar derisa të sigurohet sovraniteti dhe integriteti i plotë territorial i Kosovës, si parakusht për demokraci të qëndrueshme dhe sundim të ligjit, Perëndimi, ka treguar performancë jo të mirë në demokratizimin e mëtutjeshëm dhe sundimin e ligjit, si pasojë e mungesës së vizionit strategjik. Duke i koncentruar përpjekjet e tyre në zgjidhjen e konflikteve që ndërlidhen me statusin, BE dhe SHBA-të vazhdimisht u kanë dhënë prioritet këtyre çështjeve në këmbim të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Në emër të stabilitetit dhe vazhdimësisë, SHBA-të braktisën përgjegjësinë e tyre si garantues të marrëveshjes së vitit 2011. Pasi i zuri vendin SHBA-ve si akteri kryesor i Perëndimit, në vitin 2013 BE-ja toleroi miratimin Ligjit për Amnestinë, një ligj thellësisht problematik, dhe aplikoi qasje jo konsistente në fushën e sundimit të ligjit duke vendosur në njërin anë që gradualisht të tërheq kompetencat ekzekutive të EULEX, dhe në anën tjetër të mbështes krijimin e Gjykatës Speciale. BE dhe SHBA-të mbështetën krijimin e koalicionit të madh në vitin 2014, duke shkelur kështu parimet e demokracisë parlamentare. Në dhjetë komunat me shumicë Serbe, BE-ja toleroi manipulime në shkallë të gjerë në zgjedhjet lokale të vitit 2013 dhe në ato parlamentare të vitit 2014, që kishin për qëllim të sigurojnë fitoren e Listës Serbe, si subjekt politik që mbështetej nga Beogradi. Kjo mundësoi rikthimin e Beogradit në gjashtë komunat me shumicë serbe në

pjesën jugore të vendit, zhdukjen e pluralizmit politik, dhe asgjësimin e reformave të qeverisjes lokale të proklamuar nga Perëndimi si suksese gjatë viteve të mëparshme. Demokracia lokale në pjesën jugore të vendit, që edhe ashtu ishte fragjile, u shkatërrua tërësisht. Njëkohësisht nuk është shënuar ndonjë progres sa i përket demokracisë lokale në katër komunat me shumicë serbe të veriut.

Në pjesën tjetër të vendit të dominuar nga popullsia shqiptare, demokracia dhe sundimi i ligjit vazhdojnë të jenë në nivel jo të kënaqshëm dhe të rënduara nga problemet strukturore. Ekonomia e dobët dhe e paqëndrueshme e Kosovës, e bazuar kryesisht në remitancat nga jashtë, u kërcënua edhe më shumë pas rritjes parazgjedhore të pagave në sektorin publik për 25%. Vala e migrimit masiv të azilkërkuësve nga Kosova në vendet e anëtare të BE-së në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015 erdhi në masë të madhe si reagim i qytetarëve ndaj mënyrës se si ishte formuar qeveria. Pjesa dërmuese e qytetarëve kanë humbur shpresën që sistemi politik i vendit të tyre mund të sjellë ndryshime në të ardhmen e afërt.

Duke u përqendruar tërësisht te dialogu, i cili drejtohet duke u bazuar në veprime taktike, afatshkurtra dhe shkurtpamëse, BE dhe SHBA kanë kontribuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë të vazhdueshme në përkeqësimin e këtyre trendeve. Në më pak se një vit pasi BE mbështeti marrëveshjen e koalicionit që kishte për cak kthimin në binarë të dialogut Beograd-Prishtinë, Kosova sërish ballafaqohet me krizë institucionale, pas protestave dhe bllokadës parlamentare nga ana e opozitës. Është ironik fakti që dëmi që BE dhe SHBA i shkaktuan demokracisë së brishtë të Kosovës, tani rrezikon vetë progresin e arritur përmes dialogut. Me qëllim që të parandalohet përshkallëzimi i mëtutjeshëm i situatës dhe të forcohet demokracia e sundimi i ligjit në Kosovë, BE dhe SHBA duhet të bëjnë një sërë ndryshimesh në politikat e tyre në raport me Kosovën:

- BE dhe SHBA duhet të përmbahen nga intervenimi i drejtpërdrejt në formimin e qeverive, dhe në vend të kësaj të mbajnë qëndrime të bazuara në parimet themelore të sundimit të ligjit dhe demokracisë parlamentare. Nëse këto parime do të shkelen sërish në arritjen e marrëveshjeve për krijimin e qeverisë, atëherë BE dhe SHBA duhet të kërcënojnë me bojkotimin e qeverisë së krijuar, dhe pezullimin e proceseve integruese në BE.
- Në kuadër të kornizës së MSA-së, BE me mbështetjen e SHBA, OSBE dhe Këshillit të Evropës, duhet të inicioj proceset reformuese në sistemin zgjedhor, duke përfshirë qeverinë, partitë opozitare dhe shoqërinë civile, madje duke u bazuar në propozimet ekzistuese të sektorit të shoqërisë civile.
- BE duhet urgjentisht të zhvilloj një strategji koherente e cila maksimizon përdorimin e instrumenteve të ndryshme për promovimin e sundimit të ligjit dhe forcimin e pavarësimin e gjyqësorit. Strategjia duhet të jetë e koncentruar kryesisht në fuqizimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe shërbimit policor, në mënyrë që të trajtojnë rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe në dhënien e një roli më të rëndësishëm organizatave vendore të shoqërisë civile në promovimin e sundimit të ligjit.
- Me gjithë dallimet fundamentale në shumë politika, diplomatët e shteteve anëtare të BE dhe të SHBA duhet të nisin komunikimin me subjektin opozitar Vetëvendosje, e në veçanti SHBA duhet ti jap fund bojkotimit të kontakteve me Lëvizjen Vetëvendosje.
- FMN duhet t'ia bëjë të qartë autoriteteve kosovare se në rast se vendosin të rrisin pagat në sektorin publik para zgjedhjeve, në atë nivel sa të shkaktojnë paqëndrueshmëri fiskale, atëherë

do të ndërpriten marrëveshjet ekzistuese Standby, dhe nuk do të ketë perspektivë për marrëveshjet të tilla në të ardhmen.

- Gjermania, SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar duhet të zhvillojnë një plan gjithpërfshirës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit të Kosovës dhe sovranitetit të kufizuar përmes procesit të integritit në BE. Plani duhet të jetë i dizajnuar nga këndvështrimi i rezultateve të pritura, respektivisht anëtarësimit të Serbisë dhe Kosovës në BE, si anëtarë të plotë dhe sovran që kanë njohje reciproke.
- Berlini dhe Londra duhet ti qasen në mënyrë proaktive qytetarëve të Kosovës dhe elitave politike në mënyrë që tu shpjegojnë dhe të llojnë për politikën e tyre dhe ti sigurojnë ata se dialogu dhe eliminimi i strukturave paralele nuk do të hapë rrugën për asnjë formë të autonomisë territoriale për Serbët, që të në ardhmen do të mund të pakësonte sovranitetin e Kosovës.
- BE dhe SHBA duhet ti kthehen gjuhës së qartë dhe mesazheve drejt Beogradit sikur para vitit 2014, në mënyrë që të kufizojnë hapësirën manovruese të Qeverisë së Serbisë për qëndrimet publike në lidhje me karakterin neutral ndaj statusit që sipas tyre ka dialogu dhe marrëveshja e Prillit.
- BE duhet të insistoj që Statuti i Asociacionit të Komunave Serbe të jetë në kuadër të kornizës që ofrojnë ligjet e Kosovës, të jetë i bazuar në konceptin e funksioneve komunale, dhe të ketë kompetenca të definuara qartë.
- BE dhe SHBA duhet të kërkojnë nga Serbia që menjëherë të tërheq strukturat paralele të shtetit Serb nga komunat e Kosovës.
- BE dhe SHBA duhet të zhvillojnë një plan strategjik për eliminimin e nëntokës politiko-kriminale në veriun e vendit, si parakusht për demokraci dhe sundim të ligjit. Kjo nuk do të arrihet me integrimin e policisë serbe dhe gjyqësorit, të dy këto institucione që kanë qenë të kushtëzuara që të mos prekin këto çështje, por përmes vendosjes së themelit për transformim të suksesshëm. Plani duhet të jetë pjesë integrale e dialogut në të ardhmen, pasi të jetë implementuar tërësisht marrëveshja e Prillit.
- BE duhet të bëjë presion për të reformuar legjislacionin që ndërlidhet me financimin e subjekteve politike, duke vënë theksin në ndalimin e financimit të subjekteve politike Serbe nga Beogradi.
- BE dhe donatorët tjerë përëndimor duhet të mbështesin organizatat e shoqërisë civile, mediat e pavarura dhe akterët tjerë social që të luftojnë represionin politik të zyrtarëve komunal të Listës Serbe në komunat me shumicë Serbe në pjesën jugore të vendit dhe të krijojnë sërish kushtet themelore për pluralizmin politik.

## Hyrje

Në Nëntor të vitit 2014, dy subjektet më të mëdha politike në Kuvend, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), arritën marrëveshjen e koalicionit për formimin e qeverisë, duke i dhënë fund bllokadës politike që zgjati pothuajse gjysmë viti pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura me 8 Qershor. Marrëveshjen e mundësoi LDK, duke e lënë koalicionin e opozitës LAN<sup>1</sup>, dhe duke ju bashkuar Kryeministrit në detyrë Hashim Thaqi dhe partisë së tij PDK. Por marrëveshja kishte edhe dimensionin që ndërli dhej me Perëndimin. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa bëri publike kthesën spektakulare politike pas vizitës së zhvilluar në Berlin dhe Bruksel, ku mori mbështetjen e Zyrës së Kancelares Gjermane, deputetëve të partisë konservative në pushtet, Unionit Kristian Demokratik (CDU), dhe lidhshpimit të Partisë Popullore Europiane (EPP), anëtare të së cilës janë CDU dhe LDK.

Kjo ishte hera e dytë që Perëndimi ndërmjetësoi marrëveshje koalicioni në mes të dy partive më të mëdha që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, me qëllim të tejkalimit të krizave politike dhe institucionale. Në Prill të vitit 2011, Ambasadori i SHBA-ve në Prishtinë Christopher Dell, aranzhoi një marrëveshje në mes të PDK, LDK dhe Aleancës për Kosovën e Re (AKR), që drejtohet nga Behgjet Pacolli. Marrëveshja i dha fund krizës që kishte nisur në vjeshtën e vitit 2010, kur LDK u largua nga koalicioni qeverisës pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, i cili i ndalonte Presidentit të shtetit, Fatmir Sejdiu, që njëherit ishte edhe kryetar i LDK, që të mbante dy postet njëkohësisht. Edhe pse zgjedhjet parlamentare u zhvilluan në Dhjetor, dhe u karakterizuan me vjedhje të votave në shkallë të madhe, PDK doli fituese dhe krijoi qeverinë me AKR, por kjo nuk mjaftoi për të mundësuar stabilitet politik pasi Gjykata Kushtetuese e anuloi vendimin për zgjedhjen e Pacollit si President i vendit.<sup>2</sup> Në kuadër të marrëveshjes ishin përfshirë reforma të gjera strukturore, institucionale dhe politike, të cilat mendohej të mënjanonin defektet kryesore të sistemit politik të cilat prodhonin tension të vazhdueshëm në mes të akterëve kryesor politik. Me këtë rast ishin krijuar dy komisione ad-hoc parlamentare përgjegjëse për reformat në sistemin zgjedhor, ku parashihej krijimi i zonave zgjedhore dhe vendosja e sistemit gjysmë presidencial të qeverisjes, si dhe përgatitjen e amendamenteve kushtetuese dhe ligjore që mundësonin realizimin e reformave. Me propozim të Ambasadorit, si President i përkohshëm konsensual do të shërbente Atifete Jahjaga, ish pjesëtare e Shërbimit Policor të Kosovës e trajnuar në SHBA, deri në përfundim të reformave, zgjedhjeve të jashtëzakonshme presidenciale (që parashihnin për herë të parë zgjedhjen e drejtpërdrejt të Presidentit nga qytetarët) dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare.<sup>3</sup>

Megjithatë, këto reforma nuk u realizuan. Jahjaga u zgjodh si Presidente në vitin 2011 dhe dy komisionet e krijuara menjëherë nisën punën. Me gjithë përpjekjet e BE-së, në Komisionin për reformimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk u arrit marrëveshje për çështjet diskutabile, dhe në vitin 2013 ky komision ndërpreu punën. Amendamentet kushtetuese që parashihnin krijimin e një sistemi gjysmë presidencial të

<sup>1</sup> I emërtuar në bazë të shkornjave të para të tri subjekteve që e krijuan koalicionin, respektivisht LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), AAK (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) dhe NISMA (Nisma për Kosovën).

<sup>2</sup> *Shkaqet dhe shkasat e krizës institucionale në Kosovë. KIPRED. Prishtinë, Nëntor, 2010. Mund ta gjeni në:* [http://www.kipred.org/repository/docs/The\\_actual\\_causes\\_of\\_Kosovo%E2%80%99s\\_institutional\\_crisis\\_350846.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/The_actual_causes_of_Kosovo%E2%80%99s_institutional_crisis_350846.pdf).

<sup>3</sup> Marrëveshja politike e nënshkruar nga liderët e AKR, LDK dhe PDK, dhe garantuar me nënshkrim nga Ambasadori Amerikan Christopher Dell. Mund ta gjeni në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,1942>.

qeverisjes nuk u votuan në Kuvend. PDK mbeti në pushtet bashkë me partnerët e vegjël të koalicionit pothuajse deri në fund të mandatit të rregullt, pra deri në qershor të vitit 2014 kur u mbajtën zgjedhjet e parakohshme. Edhe Jahjaga, e cila ishte zgjedhur si Presidente e përkohshme, vazhdoi punën sipas mandatit të rregullt, duke i qëndruar lojale qeverisë së udhëhequr nga PDK. Ambasadori Dell, i cili e ka nënshkruar marrëveshjen si garantues në emër të Qeverisë Amerikane, nuk shtyu realizimin e reformave dhe u largua nga Prishtina në vitin 2012.<sup>4</sup>

Në marrëveshjen e vitit 2014, mbështetësit Perëndimor të Kosovës me Gjermaninë në krye, e cila me efikasitet e mori rolin drejtues që mbanin SHBA, pothuajse në të njëjtën mënyrë anashkaluan parimet demokratike duke bekuar veprimin e liderit të LDK Isa Mustafai cili u shkëput nga koalicioni LAN. Kjo ndodhi pas dy aktgjykimeve shumë diskutabile të Gjykatës Kushtetuese, të cilat i pamundësuan bllokut opozitar të formoj qeverinë, me gjithë faktin që kishin arritur të sigurojnë një shumicë parlamentare solide.

Të dy këto raste shpalosin dëshmi që tregojnë se Perëndimi ka ndërruar qasjen në raport me konsolidimin e demokracisë në Kosovë, pas akteve të dhunës në katër komunat me shumicë Serbe në veriun e vendit gjatë vitit 2011. Që atëherë, Perëndimi ka qenë më shumë i përqendruar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë që ndërlidhen me statusin, dhe në integrimin e veriut brenda Republikës së Kosovës. Domosdoshmëria e gjetjes së zgjidhjes për veriun dhe për sovranitetin e limituar të Kosovës bëri që SHBA dhe BE të toleroj Thaqin të shpërfill marrëveshjen e vitit 2011. Njëkohësisht, frika e Perëndimit për të ardhmen e dialogut Beograd-Prishtinë në rast se koalicioni LAN do të formonte Qeverinë<sup>5</sup>, bëri që Perëndimi të toleroj veprimet politike dhe ligjore të cilat ndikuan në krijimin e koalicionit të madh në fund të vitit 2014.

Ky raport analizon mënyrën se si Perëndimi gjatë viteve të fundit ka këmbyer demokracinë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ndërlidhen me statusin e Kosovës. Autori nuk e mohon faktin se ekziston justifikimi politik pse BE dhe SHBA kanë vendosur si prioritet kryesor zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit, po kjo do të mbetet kështu vetëm për një kohë të kufizuar. Megjithatë, kjo ngre pyetjen nëse justifikimi politik i BE dhe SHBA për marginalizimin e demokracisë është një kalkulim politik i menduar mirë, apo pasqyrim i mungesës së vizionit strategjik dhe ecjes në një lëmsh të ngatërruar. Kjo pyetje është shumë relevante tani që opozita parlamentare në Kosovë është radikalizuar, meqë ju pamundësua të formoj qeverinë. Gjatë javëve të fundit situata është përshkallëzuar në një bllokadë të plotë të punës në Kuvend dhe madje ka eskaluar në akte të dhunës. Gjithashtu, kjo analizë ngre pyetjen: Nëse qasja e Perëndimit në këmbimin e demokracisë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit ka krijuar dëme anësore në demokracinë e brishtë të Kosovës, deri në atë masë sa të paraqes kërcënim për minimin e të arriturave nga përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes të Kosovës dhe Serbisë.

<sup>4</sup> Intervistë me zyrtarë të LDK. Prishtinë, Qershor 2015. Reforma Zgjedhore. Dy vite pas, procesi kthehet në pikën zero. Instituti për Demokraci dhe Zhvillim. Prishtinë, Shtator 2013 Mund ta gjeni në: [http://d4d-ks.org/assets/D4D\\_Elections\\_5\\_ENG\\_WEB1.pdf](http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_5_ENG_WEB1.pdf)

<sup>5</sup> Intervistë me zyrtarin e zyrës së Kancelares Gjermane. Berlin. Nëntor, 2014.



## Shtetësia e hendikepuar dhe paternalizmi Perëndimor

Që nga përfundimi i luftës, çështja e balancimit të nevojës për të transformuar Kosovën në një demokraci funksionale të ndërtuar mbi parimin e sundimit të ligjit në njërin anë, dhe zgjidhjes efikase të çështjeve të hapura që ndërlidhen me statusin në anën tjetër, kanë krijuar një ndarje të mjegullt dhe jo të shëndetshme të roleve në mes të komunitetit ndërkombëtar dhe shoqërisë vendore.

Qeverisja nga një faktor i jashtëm pas vitit 1999, respektivistht nga administrimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), prezenca e institucioneve Serbe në zonat e banuara me shumicë Serbe, dhe me statusin e Kosovës ende të pazgjidhur, në vitin 2013 Kombet e Bashkuara shpалosën qasjen e “standardeve para statusit”. Kjo qasje përbëhej nga disa standarde në fushën e demokratizimit, sundimit të ligjit dhe zhvillimit ekonomik, që duhej përmbushur përgjatë procesit të transferimit gradual të përgjegjësisë nga UNMIK-u te Institucionet e Përkohshme të Vetqeverisjes Lokale, para se të adresohesh çështja e statusit, dhe hapja e rrugës për zgjidhjen përfundimtare të statusit.<sup>6</sup> Koncepti i vendosjes së rendit demokratik pa ekzistencën e shtetit të pavarur ishte i vështirë, dhe në fakt shërbeu si alibi për Perëndimin që të adresoj mungesën e vullnetit për zgjidhjen e çështjes së statusit. Siç edhe pritej, rezultatet e procesit të tranzicionit ishin të përziera. Duke transferuar administratën publike të sapo krijuar te forcat politike vendore, të legjitimuara me zgjedhjet e vitit 2001, UNMIK-u rrezikonte zhbërjen e disa të arriturave të viteve të mëparshme në fushën e qeverisjes së mirë. Profesionalizmi gradualisht u zëvendësua me familjarizëm dhe korrupsion. Shërbimi civil, edhe ashtu i fryrë, u shëndërrua në mjet të patronazhit. Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera u transferuan te partitë politike vendore, pa i prekur fare strukturat e tyre të nëntokës dhe intelegjencës, ndërkohë që rrjetet e krimit të organizuar ishin të afërta me qeverinë dhe dy partitë kryesore LDK dhe PDK. Këto struktura, që në rastin e PDK përfshinin edhe agjencionin e intelegjencës të njohur si SHIK, përfaqësonin trashëgiminë e strukturave politike, ekonomike dhe ushtarake të nëntokës shqiptare, që ishin zhvilluar gjatë viteve të 90-ta, si reagim ndaj sistemit të aparteidit që Serbia kishte instaluar në Kosovë. Kjo trashëgimi u bë pengesa kryesore në zhvillimin e sistemit demokratik të qeverisjes dhe sundimit të ligjit në Kosovë. Sa i përket ndarjes së përgjegjësisë në mes të akterëve vendor dhe ndërkombëtar, qasja e “standardeve para statusit” krijoi një situatë ku kreu i UNMIK-ut rregullisht ndërhynte në sistemin politik dhe gjyqësor të Kosovës për të ruajtur stabilitetin politik dhe bashkëpunimin në mes të klasës politike vendore. Këto intervenime shkaktuan dëme të konsiderueshme në raport me parimet e demokracisë dhe sundimit të ligjit.<sup>7</sup>

Pas deklaratës së pavarësisë së sponsorizuar nga Perëndimi në vitin 2008 dhe ndryshimit të roleve e strukturës së institucioneve ndërkombëtare nën konceptin e “pavarësisë së mbikëqyrur”, ndarja e përgjegjësisë në mes të akterëve vendor dhe ndërkombëtar u bë edhe më e mjegullt dhe joformale. Në bazë të planit të Ahtisarit, “Propozimit Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”, dhe mësimave të mësuara nga përfshirja e komunitetit ndërkombëtar pas luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, synohej

<sup>6</sup> *Standardet për Kosovën*. UNMIK/PISG, Prishtinë, Januar 2004. Mund ta gjeni në: <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf>.

<sup>7</sup> *Kosova: Sfidat e tranzicionit. Grupi Ndërkombëtar i Krizave*. Reporti Nr. 170, 17 Shkurt 2006. Mund ta gjeni në: [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/170\\_kosovo\\_\\_\\_the\\_challenge\\_of\\_transition.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/170_kosovo___the_challenge_of_transition.pdf).

krijimi i disa institucioneve ndërkombëtare me mandat dhe strategji dalëse të definuar qartë. Këto institucione ishin krijuar me qëllim që të mbështesin krijimin e institucioneve të shtetit të pavarur të Kosovës, dhe transformimin në një shoqëri demokratike dhe multietnike, përmes planit të Ahtisarit i cili shpiente drejt integritit të minoritetit Serb. Plani parashihte emërimin e një Përfaqësuesi të Lartë Civil Ndërkombëtar dhe krijimin e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), e që ishin afërsisht të ngjasme me Përfaqësuesin e Lartë dhe Zyrën e Përfaqësuesit e Lartë (OH) në Bosnje dhe Hercegovinë. Roli i tyre ishte të mbikëqyrin zbatimin e aspektit civil të planit, dhe të shërbenin si autoriteti më i lartë në interpretimin e dispozitave të tij. Në ndërkohë parashihej krijimi i institucioneve të tjera ndërkombëtare me kompetenca ekzekutive në fushën gjyqësorit, policisë dhe doganave, ndërkohë që Përfaqësuesi i Lartë Civil do të kishte autoritetin për të koordinuar të gjitha misionet ndërkombëtare prezente në Kosovë. Plani parashihte vendosjen e objektivave të qarta dhe afateve kohore për funksionimin tranzitor të këtyre institucioneve ndërkombëtare që kufizonin sovranitetin e shtetit, deri në transferimin e plotë të përgjegjësisë te institucionet vendore që do të siguronin Kosovës sovranitetin e plotë.<sup>8</sup>

Por përderisa aleati i Serbisë, Rusia, bllokonte miratimin e planit të Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Perëndimi vendosi të zgjedh një rrugë tjetër më pak të qartë. Duke u bazuar në koalicionin e vullnetit, plani i Ahtisarit u institucionalizua përmes miratimit të Kushtetutës së shtetit të pavarur të Kosovës, që u hartua me mbështetjen ligjore dhe mbikëqyrjen e Perëndimit, duke e bërë zbatimin e saj të varur nga aleanca joformale në mes të koalicionit Perëndimor të udhëhequr nga SHBA dhe elitat politike të Kosovës. Plani original u megjullua nga domosdoshmëria e implementimit të tij përmes “derës së pasme”, por edhe më shumë nga ndarjet në Perëndim, duke marrë parasysh faktin se pesë shtete<sup>9</sup> anëtare të BE refuzuan të njohin shtetin e pavarur të Kosovës. Kjo nënkuptonte që BE nuk mund të ishte akter serioz në implementimin e planit, përderisa nuk do të krijohej vullneti politik për tejkalimin e ndasive të brendshme. Pa rezolutë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK nuk e përmbylli mandatin, dhe si mision neutral në raport me statusin nuk mund të bashkëpunonte me Përfaqësuesin e Lartë Civil. Për më tepër, Përfaqësuesi i Lartë Civil asnjëherë nuk arriti të shtrijë autoritetin e tij te misionet tjera ndërkombëtare (KFOR, OSBE, EULEX), meqë misionet si ai i BE për sundimin e ligjit EULEX de facto pranuan qëndrimin neutral në raport me statusin.

Mospajtimet brenda BE-së paralizuan Përfaqësuesin e Lartë Civil, i cili në të njëjtën kohë mbante edhe kapelen e Përfaqësuesit Special të BE-së (EUSR), ndërkohë që BE vazhdonte të komplikonte punën e Përfaqësuesit të Lartë Civil dhe ICO pas ndarjes së këtyre funksioneve në vitin 2011. Kjo kornizë hibride institucionale dhe performanca e dobët e përfaqësuesve ndërkombëtar në terren, i dha institucioneve dhe elitave politike vendore më shumë autoritet se që ishte paraparë fillimisht. Shumë nga reformat ligjore dhe institucionale të inicuar nga ICO mbetën të implementuara vetëm formalisht, ndërkohë që në praktikë u minuan nga kultura dominante politike dhe ligjore. Sa i përket ndërkombëtarëve, situata e detyroi SHBA që të ndërhyjë në mënyrë unilaterale dhe agresive përmes ambasadës në Prishtinë, siç ishte rasti i vitit 2011 kur Ambasadori Dell ndërmjetësoi arritjen e marrëveshjes për qeverisje. Edhe pse këto intervenime kishin rol vendimtar në stabilizimin e situatës politike në Kosovë, ato ishin të

<sup>8</sup> Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Mund ta gjeni në: [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf).

<sup>9</sup> Këto shtete janë Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

përkohshme dhe kanë pasur ndikim diskutabil në demokratizimin dhe sundimin e ligjit në vend. Dhe e tërë kjo kornizë e institucioneve ndërkombëtare nuk ofronte zgjidhje për çështjen Serbe, apo dilemën se si të shtyhet Kosova para drejt sigurimit të sovranitetit të plotë.<sup>10</sup>

Pas trazirave në pjesën veriore të Kosovës dhe shkëmbimit të zjarrit në të cilin u përfshinë ushtarët gjerman të KFOR-it në verën e vitit 2011, Kancelarja Gjermane Angela Merkel parashtrroi një ofertë për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjeve të Kosovës dhe Serbisë rreth statusit dhe integrimin e Serbëve në enklava veriore të Republikës së Kosovës, duke u kthyer këtë në parakusht kyç për anëtarësimin e Serbisë në BE. Merkel gradualisht i tejkaloi mosmarrëveshjet brenda BE-së duke marrë rol drejtues në Kosovë. Në këtë mënyrë u hap perspektiva për rregullimin e kornizës së thyer të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, dhe balancimin e autoritetit të misioneve të ndryshme ekzekutive në Kosovë – duke e kushtëzuar Serbinë me prosperitetin për integrim në BE si kornizë strategjike për transformimin demokratik në Kosovë dhe tranzicionin drejt sovranitetit të plotë.

Por në vend që të ndiqte këtë synim, Perëndimi shfrytëzoi progresin e kufizuar rreth mosmarrëveshjeve për statusin për ti dhënë fund mbikëqyrjes së pavarësisë, përfundimin e mandatit të Përfaqësuesit të Lartë Civil dhe mbylljen e ICO. Perëndimi deklaroi se procesi ishte mbyllur me sukses dhe kështu nisën një proces të rrejshëm tranzicioni. Në Janar të vitit 2012, një muaj para se Serbia u përfshi në një marrëveshje me Kosovën në kuadër të dialogut teknik në mes të dy vendeve, veprim ky me të cilin u shpërblye me marrjen e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE, Grupi Ndërkombëtar Drejtues (SIG), i përbërë nga Qeveritë e shteteve të Perëndimit që mbështetën dhe monitoruan Kosovën në rrugën drejt sovranitetit të plotë, e deklaroi të realizuar tërësisht Propozimin Gjithpërfshirës për Statusin e Kosovës (CSP) dhe mbylljen e ICO deri në fund të vitit. Derisa Perëndimi deklaroi se kushtet demokratike për tranferimin e kompetencave të institucionet dhe elitat lokale ishin përmbushur, që nga pavarësimi i vendit pak apo fare progress ishte sa i përket qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, dhe pothuajse një e treta e objektivave të përcaktuara nga ICO, kishin mbetur pa u realizuar kur ky mision ishte mbyllur. Që Propozimi Gjithpërfshirës për Statusin e Kosovës, e veçanërisht pjesa që ka të bëjë me integrimin e minoritet Serb, ka mbetur larg zbatimit të plotë, pasqyrohet në deklaratën e takimit të fundit të Grupit Drejtues Ndërkombëtar (ISG) të mbajtur në shtator të vitit 2012, e ku përmes terminologjisë së integritit të BE theksohet se Propozimi Gjithpërfshirës për Statusin e Kosovës “kryesisht” apo “në masë të madhe” ishte zbatuar. Një tregues tjetër që vërtetonte realitetin në terren (për dallim nga realiteti virtual që i ishte përshtatur vendimeve politike të Perëndimit), ishte vazhdimi i mandatit ekzekutiv të EULEX-it, ashtu sikur disa institucioneve të tjera ndërkombëtare me kompetenca ekzekutive.<sup>11</sup>

## Procesi i dialogut - këmbimi i demokracisë dhe sundimit të ligjit me zgjidhjen e çështjes së

<sup>10</sup> Intervistë me diplomatë perëndimorë, Prishtinë, 2012; Shteti pa mbikëqyrje. Analizë e KIPRED Nr. 1/12, Gusht, 2012. Mund ta gjeni në:

[http://www.kipred.org/repository/docs/The\\_\\_Unsupervised\\_State\\_Internally\\_Divided,\\_Internationally\\_Half-Legitimate\\_408063.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/The__Unsupervised_State_Internally_Divided,_Internationally_Half-Legitimate_408063.pdf).

<sup>11</sup> Intervistë me diplomatë perëndimorë, Prishtinë, 2012; Shteti pa Mbikëqyrje: Mëngjesi një ditë pas: jeta pa mbikëqyrje. Forumi 2015, Prishtinë, Gusht 2014. Mund ta gjeni në: <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/09/morning-after-ENG.pdf>; Grupi Drejtues Ndërkombëtar, konkluzionet e takimit të 14-të (24 Janar, 2012) dhe 16-të (10 Shtator, 2012).

## statusit

Paralelisht me procesin e vendimmarrjes për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, në Serbi u zhvilluan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, të cilat në verën e vitit 2002 e sollën në pushtet Partinë Progresive Serbe (SNS). Beogradi dhe Prishtina e nisën dialogun e ndërmjetësuar nga BE në Tetor të vitit 2012, bazuar në deklaratat e qarta të Berlinit se Kosova asnjëherë nuk do të kthehet nën kontrollin e Serbisë dhe kërkesa politike strikte për të pranuar këtë realitet do të ishte parakusht për Serbinë për të shënuar progres në procesin e anëtarësimit në BE. Në Prill të vitit 2013, këto bisedime sollën marrëveshjen bazë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas këtyre zhvillimeve e tërë vëmendja e akterëve dhe institucioneve ndërkombëtare në Kosovë ndryshoi rrënjësisht. Përderisa ishte vendosur që institucionet civile me kompetenca ekzekutive si EULEX gradualisht të tërhiqeshin, lidhshipi i Perëndimit u ndërrua nga SHBA te BE. Udhëheqja formale e dialogut i'u besua Përfaqësueses së Lartë të BE për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, Catherine Ashton, përderisa lidhshipi real brenda BE-së mbeti gjysmë i fshehur tek Gjermania. Gjermania ishte drejtuese e këtij procesi (bashkë me Mbretërinë e Bashkuar) ndërkohë që SHBA-të morën rol mbështetës duke kryer pjesën më të madhe të "përdredhjes së duarve" të autoriteteve të Prishtinës dhe Qeverisë Thaçi. Gjithashtu, ajo çfarë Gjermania dhe BE fitonin në Kosovë ishte krijimi i një mekanizmi indirekt sipas të cilit: autoritetet në Berlin konsideronin se Serbia do të pranonte kushtet për anëtarësim në BE dhe qëndrimi i pesë shteteve anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën do të zbutej, gjë që do të zhbllokonte procesin e integritetit të Kosovës, me gjithë faktin se në aspektin strukturor shteti i ri i Kosovës mbetej dukshëm pas Serbisë në procesin e gjatë të anëtarësimit. Edhe më i rëndësishëm se mekanizmat institucional dhe parainstitucional të qasjes së Perëndimit në Kosovë, ishte fakti që sukcesi i marrëveshjes së Prillit e ktheu dialogun në prioritet kryesor dhe të pakontestueshëm për politikën e Perëndimit në raport me Kosovën. Që atëherë çështja e demokratizimit të vendit ka mbetur nën hijen e dialogut, veçanërisht në rastet kur procesi i demokratizimit dhe procesi për zgjidhjen e çështjeve rreth statusit binin ndesh.

### *Ligji për Amnisti*

Në fillim të vitit 2013, Qeveria e Kosovës dorëzoi në Kuvend projektligjin për Amnisti, gjë që shkaktoi përplasjen e parë në mes të prioriteteve për zbatimin e marrëveshjes së Prillit. Projektligji ishte pjesë e planit të implementimit për të cilin palët u pajtuan në muajin Maj. Amnistimi i qytetarëve Serb të veriut të Kosovës për veprat penale të cilat i kishin kryer si rezultat i të jetuarit nën juridiksionin e shtetit Serb ishte përcaktuar si parakusht për shpërbërjen e strukturave paralele. Marrëveshja parashihte integrimin e gjyqësorit dhe policisë në kuadër të institucioneve zyrtare të shtetit të Kosovës, ndërkohë që zgjedhjet lokale do të organizoheshin në përputhje me ligjet e Kosovës. Palët që nënshkruan marrëveshjen tashmë kishin shkelur afatin e përcaktuar në muajin Qershor, ngase negociatat në lidhje me projektligjin kishin zgjatur më shumë se që ishte paraparë. Siç shpjegon një jurist i EULEX-it i përfshirë në këtë proces "Se e kishim në një rënë anë projektligjin fillestar të përgatitur nga Qeveria, dhe propozimin e Beogradit për amnisti në shkallë më të gjerë i cili nuk ishte i pranueshëm nga Qeveria, por edhe nga komuniteti ndërkombëtar, të cilët refuzuan amnestinë për sulme ndaj ndërkombëtarëve. Ne arritëm të zvogëlojmë

numrin e veprave penale të cilat kualifikoheshin për amnisti.”<sup>12</sup> Por deri në kohën kur u dorëzua në Kuvend, projektligji pësoi ndryshime rrënjësore. Ministri i Drejtësisë Hajredin Kuçi, një nga aleatët më të afërt politik të Hashim Thaçit, kishte vendosur që në momentin e fundit të integronte një projektligj tërësisht të ndryshëm në projektligjin për të cilin ishte arritur marrëveshja. Kjo pjesë e projektligjit nuk kishte të bënte me Serbët e veriut por për pjesën tjetër të territorit të Kosovës, dhe parashihte amnisti për një numër të madh të veprave penale. Përmes këtij ligji synohej të amnistoheshin anëtarët dhe bashkëpunëtorët e PDK, në mesin e të cilëve nëntë kryetarë komunash të cilët ishin nën hetim për vepra penale, por ligji si i tillë u shkante për shtati pjesës më të madhe të partive opozitare. Si pasojë, për miratimin e projektligjit u siguroi shumica e votave, por për pak nuk arritën 2/3 e nevojshme për miratimin e tij. Një nga deputetët që votoi kundër projektligjit të parë theksoi se “gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit vetëm disa ambasadorë ishin prezent, dhe kjo ishte e çuditshme. Shumica e diplomatëve thonin që “ne nuk kemi ndonjë qëndrim për këtë projektligj”. Vetëm disa ambasadorë të shteteve të vogla na këshilluan që të votojmë kundër”<sup>13</sup> Pas votimit, një pjesë e shoqërisë civile në Kosovë dhe Lëvizja Vetëvendosje nga radhët e opozitës arritën të mobilizojnë publikun për të kundërshtuar këtë projektligj. Vetëm ambasadori i Holandës e kritikoi publikisht projektligjin, ndërkohë që të tjerët zhvillonin negociata pas dyerve të mbyllura me subjektet politike të koalicionit qeverisës dhe opozitës. Një javë më vonë, u procedua një projektligj i ndryshuar i cili u hodh në votim dhe siguroi mbështetjen e 2/3 së votave. Projektligji kishte pësuar disa ndryshime, por dispozitat diskutabile kishin mbetur të paprekura. Deputeti i njëjtë shpjegonte se “Pas votimit të parë, Zëvendës Asistenti i Sekretarit të Shtetit Philip Reeker vizitoi Kosovën duke na thënë se “kushdo që është kundër ligjit për amnistinë është kundër SHBA-ve”, duke theksuar se “jam këtu të flas në emër të Barack Obamas”. Gjatë shqyrtimit të dytë në Kuvend, shumica e ambasadorëve të Europës thonin se ata e mbështesin miratimin projektligjit megjithëse mbetej problematik.<sup>14</sup> Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje e sfiduan ligjin e miratuar në Gjykatën Kushtetuese. Aktgjykimi i Gjykatës që duket se ishte ndikuar nga presioni politik i Qeverisë, përcaktonte se amnistia për gjysmën e veprave penale të listuara në ligj e që kishin të bëjnë me shkatërrimin e pronës, zjarrvënien dhe falsifikimin e dokumenteve binin ndesh me Kushtetutën, ndërkohë që gjysma tjetër e listës së veprave penale ishte në rregull. Siç do të theksonte në mendimin e tij kundërshtues, gjyqtari amerikan Robert Carolan, një nga tre gjyqtarët ndërkombëtar, Kuvendi i Kosovës ka kompetenca kushtetuese për të dhënë amnisti për të gjitha veprat penale me përjashtim të atyre që kufizohen me të drejtën dhe traktatet ndërkombëtare. Një gjyqtar i EULEX-it në atë kohë mbështeste këtë mendim, duke shpjeguar se “ligjet e amnistisë janë çështje politike, jo legale, dhe se vendimi i Gjykatës për të refuzuar amnistinë për vepra të caktuara penale është plotësisht arbitrar”.<sup>15</sup> Përmes këtij aktgjykimi të kompromisit, Gjykata balancoi qëndrimet politike dhe ligjore që u shërbenin interesave të Qeverisë dhe Perëndimit, dhe i dha fund vonesës tre mujore për zbatimin e marrëveshjes së Prillit. Në këtë rast BE dhe SHBA i ndihmuan Gjykatës,

<sup>12</sup> Intervistë me jurist të EULEX. Prishtinë, Shtator 2013.

<sup>13</sup> Intervistë me deputetë të opozitës, Prishtinë, Shtator 2013.

<sup>14</sup> Ibid.

<sup>15</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Shqyrtimi kushtetues i Ligjit Nr. 04/L-209, për Amnisti. Mund ta gjeni në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_108\\_13\\_ang.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_108_13_ang.pdf); Mendimi mospajtuës i gjyqtarit Robert Carolan. Mund ta gjeni në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_108\\_13\\_mkm\\_1\\_ang.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_108_13_mkm_1_ang.pdf); Intervistë me jurist të EULEX. Prishtinë, Shtator, 2013; “Shoqëria civile kritikon Ligjin për Amnisti,” *Radio Evropa e Lirë*, 4 Shtator.2013, Mund ta gjeni në: <http://www.slobodnaevropa.org/content/civilno-drustvo-kritikuje-zakon-o-amnestiji/25095721.html>.

Qeverisë së udhëhequr nga PDK dhe deputetëve që ti shkaktojnë një dëm të madh sundimit të ligjit në Kosovë.

### *Tërheqja graduale e EULEX dhe krijimi i Gjykatës Speciale*

Në vitet 2014 dhe 2015, Perëndimi i dha shtytje përcaktimit të mandatit të ri për EULEX-in dhe krijimin e Gjykatës Speciale, dy procese këto kontradiktore me njëra tjetrën, që i shkaktojnë dëme sundimit të ligjit në Kosovë dhe synimit të proklamuar nga Qeveria për të promovuar një gjyqësor të pavarur dhe efikas. Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes së Prillit, si pjesë të planit për vazhdimin e mandatit aktual, BE nisi procedurat standarde të vlerësimit të mandatit dy vjeçar të EULEX, që do të përfundonte në Qershor të vitit 2014.<sup>16</sup> Dy arkitektët kryesor të dialogut në BE, Berlini dhe Londra, propozuan një dokument ku përcaktohej korniza për mandatin e ri të EULEX. Ky dokument propozonte vazhdimin dhe forcimin e mandatit ekzekutiv në pjesën veriore të vendit për të mbështetur integrimin e strukturave paralele policore dhe gjyqësore, dhe tërheqjen graduale të EULEX nga pjesa tjetër e vendit, duke kufizuar punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar vetëm në rastet që janë në procedurë. Ky propozim shërbeu si udhëzues për vlerësimin strategjik të EULEX nga ana e Shërbimit për Veprim të Jashtëm Europian (EEAS). Ashtu si në rastin e ICO në vitin 2012, shteteve kyçe të BE-së ju prezantua një mundësi për të përmirësuar një mision puna e të cilit në masë të madhe ishte penguar nga ndarjet e brendshme brenda BE-së në lidhje me Kosovën, ndërkohë që mundësia e EULEX për të hetuar rastet e nivelit të lartë dhe politikisht të ndjeshme të korrupsionit dhe krimit të organizuar ishin kufizuar edhe nga pengesat strukturore. Ashtu si në rastin e ICO, BE nën lidhshirin Gjerman dhe Britanik vendosi të shkojë drejt mbylljes së EULEX, në vend që të sigurohej që të ketë ndikim të qëndrueshëm në promovimin e sundimit të ligjit, dhe të shfrytëzojë pjesë të EULEX për të mbështetur zbatimin e marrëveshjes së Prillit.

Duke ndjekur këtë drejtim, vlerësimi strategjik i EEAS përshkruante gjendjen në sistemin gjyqësor të Kosovës shumë më mirë se që ishte realiteti në terren, ndërkohë që gjatë bisedave në sfond gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX, pa u dëgjuar nga askush në Bruksel, tërhiqnin vërejtjen se kolegët e tyre vendor ende nuk janë të gatshëm të merren me çështje të ndjeshme. Një prej tyre theksoi se “Ata nuk mund të iniciojnë raste të nivelit të lartë. Nëse ne nuk i iniciojmë rastet, asnjë person i profilit publik nuk do të hetohet ndonjëherë. Politika e mos nisjes së rasteve të reja është fitore e plotë për Qeverinë e Kosovës. E gjithë garda e vjetër tani mund të ndihet e sigurt”. Kritika ka pasur edhe brenda BE-së, ku një bashkëbisedues i referohet “kthimit përmbys të prioritetëve si diçka tipike për tregimet e BE-së”. Pyetja nëse institucionet e Kosovës janë të gatshme nuk është pika prej nga duhet nisur vlerësimi strategjik, ngase kjo pashmangshëm të shtyen në manipulimin e objektivave për mbyllje”. Por këto kritika kanë pasur efekt të kufizuar. Se vendimi politik pas dokumentit kornizë ka qenë, sipas fjalëve të një diplomati të BE-së “sa për ti dhënë diçka Prishtinës” si kompensim për përfshirjen konstruktive në dialog u bë i qartë kur EEAS i vuri në dispozicion Qeverisë së Kosovës draftin e vlerësimit strategjik duke i mundësuar që të dorëzojë edhe një

<sup>16</sup> Referencat në vijim janë të bazuara në raportin e EULEX – *Drejt strategjisë së integruar dalëse. Forcimi i sundimit të ligjit përmes integritetit në BE. Këshilli për Politikën e Demokratizimit (DPC) – Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Berlin-Prishtinë, Prill 2014, Mund ta gjeni në: [http://democratizationpolicy.org/uimages/EULEX\\_Exit\\_Strategy\\_DPC-GLPS\\_Policy\\_Report\\_\(04-14\)\\_ENG.pdf](http://democratizationpolicy.org/uimages/EULEX_Exit_Strategy_DPC-GLPS_Policy_Report_(04-14)_ENG.pdf); pp. 23-32.*

qëndrim të saj me shkrim, para se vendet anëtare të BE pranuan dokumentin dhe vendosen për qëndrimin e BE për të ardhmen e mandatit të EULEX mbi bazën e të cilit më pas do të nisnin negociatat formale me Qeverinë. Në fund, BE-ja lëshoi pe shumë ndaj presionit të Prishtinës zyrtare për të mbyllur EULEX-in. Vendimi për të krijuar një mandat të ri ishte më i keq se mbyllja e tërësishme apo korrigjimi i misionit përmes tërheqjes graduale të mandatit ekzekutiv, duke u bazuar në objektiva reale përmes të cilave do të matej aftësia e gjyqësorit vendor për të marrë përsipër rastet e ndjeshme ligjore që ishin trajtuar nga ndërkombëtarët, se sa lidhja e fatit të EULEX me afate politike artificiale. Për më tepër, EEAS u tregua i ngathët në përmbushjen e përgatitjeve për mandatin e ri në afatin e caktuar, dhe përfundoi me nguti në kohën kur Kuvendi i Kosovës po shpërndahej dhe zgjedhjet e parakohshme po afroheshin. Për pasojë, ligjet e amendamentuara për të siguruar mandatin e ri dy vjeçar të EULEX, në seancat e fundit të Kuvendit në Prill të vitit 2014, kishin mangësi të shumta e që nuk ishin të pranueshme për një mision të sundimit të ligjit.

Përpyekjet e BE-së për të siguruar shumicën parlamentare të nevojshme për miratimin e mandatit të ri të EULEX mbetën nën hijen e një sfide shumë të madhe politike me Qeverinë e Kosovës dhe opozitën rreth krijimit të Gjykatës Speciale, lëvizje kjo që erdhi pas një vlerësimi tërësishëm të ndryshëm të gjendjes në sistemin gjyqësor dhe të sundimit të ligjit në Kosovë. Në pranverë të vitit 2014, Kryeprokurori i Task Forcës për Hetime të Veçanta (SITF) ishte në përfundim të raportit përfundimtar, ku parashihej krijimi i gjykatës speciale. SITF ishte themeluar nga BE në vitin 2011 për të hetuar dyshimet e ngritura në raportin e Këshillit të Evropës hartuar nga Dick Marty për krimet kundër Serbëve dhe minoriteteve tjera që pretendohesh se ishin kryer nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) gjatë dhe veçanërisht pas luftës së vitit 1999, e veçanërisht pretendimeve për vrasje me qëllim të trafikimit dhe transplantimit të organeve. Plani i BE dhe SHBA për të krijuar një gjykatë diku jashtë Kosovës, në një nga shtetet anëtare të BE, por që formalisht do të ishte në kuadër të rendit kushtetues të shtetit të Kosovës, doli të jetë një përpjekje jo e lehtë. Qeveria në Prishtinë nuk tregonte gatishmëri për të mbështetur krijimin e Gjykatës, sepse ishin rritur spekulimet për listën e të akuzuarve të mundshëm e ku përfshiheshin edhe Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, shef i SHIK-ut dhe nënkryetar i PDK.

Me 24 Prill, 2014, pas presionit të fuqishëm nga BE dhe veçanërisht nga SHBA, koalicioni qeverisës me shumicë të thjeshtë parlamentare ratifikoi marrëveshjen me BE-në për krijimin e Gjykatës Speciale, duke e votuar atë në pako bashkë me misionin e ri të EULEX-it. Më pas në fillim të vitit 2015, kur nevojitej miratimi i amendamenteve kushtetuese dhe ligjit për krijimin e Gjykatës Speciale, koalicioni qeverisës PDK-LDK u ndesh me probleme më serioze, me gjithë faktin se numri i deputetëve të subjekteve politike në koalicionin qeverisës kalonin 2/3 e numrit të pëgjithshëm të deputetëve. Gjatë votimit të parë një numër i madh i deputetëve të PDK votuan kundër amendamentit dhe ligjit, por më pas ato kaluan në një seancë tjetër të zhvilluar në muajin Gusht. Në fund, krijimi i bazës ligjore për Gjykatën ishte arritur përmes kërcënimit me ndërprerje të marrëdhënieve në mes të Perëndimit dhe Prishtinës, ndërkohë që Ambasadorja e SHBA Tracey Jacobson kërcënonte se në rast të mos votimit SHBA do të mbështesnin krijimin e Gjykatës Speciale nga Kombet e Bashkuara me ndihmën e votës së Ruisë në Këshillin e Sigurimit. Kërcënimi i kësaj të fundit ishte një manovër politike e çuditshme kur kemi parasysh qëndrimin refuzues të Moskës ndaj pavarësisë së Kosovës, kontekstet gjeopolitik të dominuar nga agresioni i Ruisë në Ukrainë, dhe fakti se Rusia ka qenë mbështetësi më i madh i Serbisë në shëndrrimin e çështjes së trafikimit

të organeve në mit të viktimizimit kombëtar që shkon përtej fakteve ekzistuese. Është e paqartë pse SHBA e konsideronte këtë formë të kërcënimit, kur dihet se kërcënimi i ndërprerjes së marrëdhënieve të SHBA me qeverinë e Kosovës nuk ishte më pak efektiv se kërcënimi për të përfshirë në lojë Moskën dhe Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Qëndrimet dhe politikat e Perëndimit për themelimin e Gjykatës Speciale tregojnë si asgjë tjetër mos konsistencën e BE në angazhimin për sundim të ligjit në Kosovë. Vetë vendimi për themelimin e një gjykatë të re dhe të ndarë nga sistemi i drejtësisë, në mënyrë implicite vërteton dështimin e UNMIK dhe EULEX në hetimin e këtyre rasteve të ndjeshme. Krijimi i Gjykatës duhet si veprim i çuditshëm nëse kemi parasysh një deklaratë të Kryeprokurorit të Task Forcës, Clint Williamson, të dhënë në Korrik të vitit 2014. Duke përmbledhur hetimet e zhvilluara gjatë periudhës para themelimit të Gjykatës, Williamson shpjegonte se ekipi i tij kishte gjetur dëshmi vetëm për një numër të vogël të rasteve që kishin të bënin me trafikim të organeve, madje një numër shumë më të vogël të rasteve se që perceptohej nga opinioni publik në Serbi, e që tregon se kjo fushatë atje edhe i ka dhënë vëmendje më të madhe kësaj çështje në rrafshin ndërkomëtar.<sup>17</sup>

Mos konsistenca e BE-së në këtë drejtim shihet më së miri nga fakti se këtu kemi të bëjmë me një gjykatë de fakto të huaj, me gjyqtarë dhe prokurorë të huaj, dhe me procese gjyqësore që do të zhvillohen jashtë territorit të Kosovës. Në deklaratën e tij, Williamson jo vetëm që pranoi në mënyrë implicite se gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës nuk mund të gjykojnë këto raste të ndjeshme politike, por në mënyrë eksplicite deklaroi se me disa nga të akuzuarit e mundshëm që ende mbajnë poste politike, mbrojtja e dëshmitarëve në territorin e Kosovës nuk është e mundur. Ky vlerësim mbi sundimin e ligjit në Kosovë ishte diametralisht i kundërt me vlerësimin e BE-së mbi bazën e të cilit ishte vendosur tërheqjen graduale të kompetencave ekzekutive të EULEX me mandatin e ri.<sup>18</sup>

### *Kriza e vitit 2014 për formimin e qeverisë*

Plani i Majit të vitit 2013 për zbatimin e marrëveshjes së Prillit kishte caktuar fundin e vitit, si afat kohor vështirë të realizueshëm, për shpërbërjen e shtyllave kryesore të sistemit paralel në veriun e Kosovës. Viti 2014 nisi me vonesa në zbatimin e planit, ndërkohë që zgjedhjet e parakohshme në Serbi në muajin Mars dhe në Kosovë në muajin Qershor, si dhe zgjedhjet për Parlamentin Europian në muajin Maj, e bllokuan procesin gjatë tërë vitit. Sfidat më të mëdha për Perëndimin në atë kohë ishte bllokada politike dhe institucionale për formimin e Qeverisë në Kosovë, e cila zgjati për pesë muaj.

Për herë të parë pas shpalljes së pavarësisë, pjesa më e madhe e subjekteve politike ishin në pozitë jo të

<sup>17</sup> “Deklarata e Kryeprokurorit të Task Forcës për Hetime të Veçanta”. 29 Korrik, 2014. Mund ta gjeni në: [http://sitf.eu/images/Statement/Statement\\_of\\_the\\_Chief\\_Prosecutor\\_of\\_the\\_SITF\\_EN.pdf](http://sitf.eu/images/Statement/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_EN.pdf).

<sup>18</sup> Intervista me diplomatë perëndimor dhe ekspertë gjyqësor vendor. Prishtinë, 2014-15; Rreziqet për Republikën e Kosovës në rast se Kuvendi dështon të krijoj Gjykatën Speciale. Opinion i GLPS Nr. 4, Prishtinë, Pril 2015, Mund a gjeni në: “Deklarata e Kryeprokurorit të Task Forcës për Hetime të Veçanta”. 29 Korrik, 2014. Mund ta gjeni në: <http://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2015/05/Riks-for-the-Republic-of-Kosovo-if-the-Parliament-Fails-to-Establish-the-Special-Court.pdf>; Ligji për Gjykatën Speciale dhe Zyrën e Prokurorit Special. Mund ta gjeni në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-053%20a.pdf>; Andrea Lorenzo Capussela, “Gjashtë paradokset e Gjykatës Speciale të Kosovës”. Mund ta gjeni në: <http://www.balkanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Kosovo/The-six-paradoxes-of-Kosovo-s-special-court-162735>.



volitshme para se të hynin në fushatën para zgjedhore për zgjedhjet e 8 Qershorit. PDK e cila ishte në pushtet nga viti 2008, u bë shumë e varur nga dialogu për sa kohë që sukseset në politikën e brendshme ishin të vogla. Kryetari i LDK ishte dëmtuar dukshëm pasi kishte humbur garën për kryetar të komunës në Prishtinë, në zgjedhjet e vitit 2013. Ramush Haradinaj i cili sapo ishte kthyer nga tribunali i Kombeve të Bashkuara për krime lufte në Hagë, duke j shpëputur nga realiteti politik në vend, dhe priste PDK të hynte në koalicion me partinë e tij AAK (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) e cila do ti ofronte atij postin e Kryeministrit, duke u bazuar thjesht në karizmën që gëzonte para se të shkonte në Hagë. Lëvizja Vetëvendosja e cila nga një lëvizje e të rinjve u shëndrrua në subjekt politik arriti sukses të madh në fitoren për kryetar komune në Prishtinë, kryesisht falë karizmës së kandidatit të saj Shpend Ahmeti, por dështoi të zgjeronte radhët e saj në tërë vendin, siç edhe shpresonte.

Në fund të procesit zgjedhor, rezultatet treguan se balanci i forcave në Kuvend nuk ndryshoi shumë. Me 30% të votave, duke shënuar një rënie të vogël, PDK megjithatë doli subjekti më i madh politik. Edhe AAK shënoi rënie të vogël ndërsa LDK dhe Vetëvendosje rritën bazën e votuesve. Megjithatë, dy faktorë ndikuan në ndryshimin e balancit të fuqisë. Faktori i parë ishte mos kalimi i pragut zgjedhor nga AKR, e cila ishte partner i vogël në qeverisjen me PDK, dhe hyrja në Kuvend e NISMËS, parti e re kjo e krijuar nga dy prej themeluesve të PDK. Faktori i dytë ishte vendimi i LDK që ti bashkëngjiten AAK dhe NISMËS në formimin e koalicionit pas zgjedhor LAN, i cili i pamundësoi Thaçit mundësinë që të bëhet Kryeministër, duke bërë kështu që PDK për herë të parë të humb mundësinë për formimin e shumicës parlamentare. Me 47 deputetë në Kuvendin e përbërë nga 120 deputetë, dhe me mbështetjen potenciale të 16 deputetëve të Vetëvendosje, LAN qëndronte përballë PDK e cila kishte vetëm 38 deputetë. Por PDK refuzoi të largohej nga pushteti, dhe vendi hyri në një sfidë politike e cila u shëndërrua në konflikt për zgjidhjen e të cilit nevojiteshin masa ligjore dhe kushtetuese. Të dy grupet argumentonin se Kushtetuta autorizon Presidentin që të “caktoj kandidatin për Kryeministër me propozim të partisë politike apo koalicionit që ka shumicën në Kuvend” (Neni 84.14), por në këtë rast termi “koalicion” a i referohet edhe koalicioneve pas zgjedhore të subjekteve politike? Një pyetje e njëjtë u ngrit edhe për dispozitën tjetër ku thuhet se “Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve” (Neni 67.2), mbi bazën e të cilit PDK kundërshtonte zgjedhjen e Isa Mustafës me 17 Korrik si Kryetar i Kuvendit me votat e LAN, Vetëvendosjes dhe përfaqësueve të minoriteteve. Të dy rastet u dërguan për interpretim në Gjykatën Kushtetuese, dhe në të dy rastet Gjykata mbështeti interpretimin e PDK-së, me aktgjykimet e datës 1 korrik dhe 26 gusht. Me aktgjykimin e dytë i cili anulonte vendimin e zgjedhjes së Mustafës si Kryetar i Kuvendit, gjyqtarët i ofruan PDK-së mundësinë për të bllokuar krijimin e qeverisë në pafundësi. Në të njëjtën kohë, aktgjykimet e vendosën koalicionin LAN në pozitë shumë të vështirë, sepse marrëveshja e tyre bazohej në dhënien e postit të Kryeministrit Ramush Haradinajt dhe postin Kryeparlamentarit Isa Mustafës, por tani marrëveshja duhej rishikuar.

Bazuar në të gjitha burimet e disponueshme, është evident fakti se aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese ishin të motivuara politikisht. Juristë vendorë dhe ndërkombëtar që morën pjesë në hartimin e Kushtetutës së Kosovës kritikuan publikisht Gjykatën Kushtetuese për interpretimin e ngushtë të tekstit të Kushtetutës. Sipas tyre, aktgjykimet e Gjykatës nuk ishin në frymën e Kushtetutës, e cila ishte hartuar në atë mënyrë që të lejonte me lehtësi krijimin e Qeverive pas zgjedhjeve. Në kohën kur juristët e Gjykatës

Kushtetuese po shqyrtonin çështjen, çuditërisht i tërë dokumentacioni i komisionit përgjegjës për hartimin e Kushtetutës ishte zhdukur nga arkivi, dhe pas përfundimit të procesit në Gjykatë u gjet përsëri. Me dy mendimet e tij mospajtuese, gjyqtari amerikan në Gjykatën Kushtetuese, Robert Carolan shkoi një hap tutje duke shpjeguar pse interpretimi legal i termit “koalicion” dhe “grup parlamentar” nga shumica e gjyqtarëve ishte i gabuar.<sup>19</sup>

Në një situatë ku kriza dukej se nuk do të zgjidhej, Perëndimi nisi të vepronte. Zyrtarët dhe diplomatët Perëndimor ishin plotësisht të vetëdijshëm me sfondin që qëndronte pas vendimeve të Gjykatës. Siç shpjegonte një ekspert i Komisionit Evropian “në draftin e raportit të progresit për vitin 2014 në të shkruam se Gjykata Kushtetuese mori vendime të motivuara politikisht, por kolegji i komisionerëve e fshiu këtë pjesë me argumentin se “nuk kemi dëshmi për këtë”. Si BE ashtu edhe SHBA ishin më pas agresive në qasjen e tyre në krahasim me vitin 2011, kur Ambasadori i atëhershëm Dell krekosej para kolegëve të tij Perëndimor se zgjedhja e Atifete Jahjagës në postin e Presidentes ishte ide e shkëlqyeshme dhe meritë personale e tij. Zyrtarët e BE-së dhe SHBA-ve ishin të qartë nga fillimi, se nuk do të ndërhyenin në krijimin e koalicionit. Një diplomat amerikan theksonte se “kjo nuk ishte punë e lehtë. Liderët vendor sërish vijjnë tek ne si në kohët e vjetra duke thënë “na tregoni se çfarë duhet të bëjmë”, ndërkohë që ne u themi se “ne nuk punojmë më në atë formë, por ata thjesht nuk na besojnë”. Megjithatë, ambasadorë të ndryshëm të shteteve të Perëndimit mbanin qëndrime të ndryshme, por ato ishte vështirë të definohen. Por së paku në rastin e Gjermanisë, zyra e Kancelares së Partisë Demokristiane (CDU) kishte qëndrim neutral, me gjithë faktin se intervenuan në një formë të caktuar, duke e bërë të qartë para liderëve të LAN se dialogu me Serbinë duhet të vazhdoj dhe se ata duhet të zotohen për zbatimin e marrëveshjes së Prillit. Ky qëndrim mbështetej edhe nga aleatët tjerë të Perëndimit. Në këtë frymë, përfaqësuesi i Kancelares deputeti i CDU Andrea Schockenhoff, një nga arkitektët e dialogut Kosovë-Serbi udhëtoi për në Prishtinë në Korrik, ku mori premtimin e liderëve të LAN se ata nuk do të lidhin koalicion formal me Lëvizjen Vetëvendosje, por pasi u kthye në Berlin e kuptoi që LAN kishte shkelur premtimin.

Në rrethanat e reja që i pamundësuan Isa Mustafës të zgjedhet Kryetar i Kuvendit, koalicioni LAN nuk arriti të rishikoj dhe të pajtohem për marrëveshje të re të koalicionit. Në Nëntor, lideri i LDK-së Isa Mustafa udhëtoi për në Berlin ku u takua me zyrtarë të Zyës së Kancelares dhe atyre të CDU, dhe në Bruksel ku u takua me lidërsipin e Partisë Popullore Europiane (EPP). Mustafa u takua dy herë me deputetin e bundestagut Schockenhoff dhe më këshilltarët për politikë të jashtme të Merkel. Në deklaratat publike Mustafa theksonte se ai ishte i detyruar të lëvizte drejt koalicionit me PDK, por vendimin për këtë kthesë politike ai e kishte marrë para se të nisej për në Berlin dhe Bruksel, ku thjesht kërkonte mbështetje ndërkombëtare. Një zyrtar i Zyrës së Kancelares konfirmoi se “Mustafa tashmë kishte ndryshuar drejtimin dhe kërkonte mbështetjen tonë, të cilën ne ja ofruam. Madje, ne i shpjeguam se nuk jemi ithtarë të

<sup>19</sup> Nate Tabak, “Aktgjykimet thellojnë krizën politike,” *Prishtina Insight*, 12-25 Shtator, 2014, f. 5-9; intervista me përfaqësues të subjekteve politike, Prishtinë, 2015; Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykim në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë së Nenit 84.14 (Kompetencat e Presidentit me Nenin 95 (Zgjedhja e Qeverisë) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. 1 Korrik, 2014, Mund ta gjeni në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_103\\_14\\_ang.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_103_14_ang.pdf); Mendimi mospajtuës i Gjyqtarit Robert Carolan. Mund ta gjeni në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_103\\_14\\_mm\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_103_14_mm_shq.pdf); Shqyrtim Kushtetues i Vendimit Nr. 05-V-001 i votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit. 17 Korrik 2014, Mund ta gjeni në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk\\_ko\\_119\\_14\\_ang.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_119_14_ang.pdf); Mendimi mospajtuës i gjyqtarit Robert Carolan. Mund ta gjeni në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ko\\_119\\_14\\_mm\\_ang.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_119_14_mm_ang.pdf).

koalicioneve të mëdha, por kjo dukej se ishte rruga e vetme për të dalë nga kriza”. Ai gjithashtu shtoi se “me hyrjen e Vetëvendosjes në koalicionin LAN dhe me vendimin që ata të udhëheqin procesin e dialogut në qeverinë e LAN, ne u frikësuam për të ardhmen e dialogut dhe për integrimin e veriut”. Pasi siguroi mbështetjen e Berlinit dhe EPP, menjëherë pas kthimit në Prishtinë ai deklaroi se do të hynte në koalicion me PDK. Krizës i erdhi fundi pas pesë muajve, ndërkohë që mesazhi i qartë për qytetarët e Kosovës ishte se rregulla fundamentale e demokracisë, që pas zgjedhjeve shumica e deputetëve mund të formojnë qeverinë, nuk gjen aplikim në shtetin e tyre.<sup>20</sup>

## Shpërbërja e strukturave paralele - pyetjet që ndërlidhen me demokracinë

### *Përfshirja e Serbëve në strukturat e shtetit – zgjedhjet lokale dhe parlamentare të vitve 2013-2014*

Si pjesë të shpërbërjes së strukturave paralele të shtetit Serb në Kosovë, veçanërisht në pjesën veriore të vendit, marrëveshja e Prillit parashihte që gjatë vitit 2013 të mbahen zgjedhjet lokale në katër komunat me shumicë Serbe në veri të lumit Ibër (Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan), dhe atë në kuadër të ligjeve të Kosovës. Në Nëntor të vitit 2013 Prishtina zyrtare vendosi për mbajtjen e zgjedhjeve lokale në tërë vendin. Organizimi i zgjedhjeve lokale në katër komunat me shumicë Serbe dhe përfshirja e përfaqësuesve të tyre të zgjedhur si pjesë integrale dhe akterë të shtetit të pavarur të Kosovës, për të përmbushur kështu standardet ndërkombëtare demokratike për zgjedhje të lira dhe të drejta, u tregua të jetë një mision i pamundur, dhe atë për shumë arsye. Fillimisht, Gjermania arriti me sukses të ndryshoj kursin e BE-së për mosmarrëveshje Kosovë-Serbi, duke ja bërë të qartë Beogradit se koha e ndryshimit të kujijve në Ballkan ka përfunduar dhe se nëse dëshiron të vazhdoj rrugëtimin drejt BE-së, duhet të pranoj faktin se Kosova është shtet i pavarur. Megjithatë, kjo qasje indirekte e përpjekjeve për të zgjidhur çështjen e statusit përmes instrumenteve politike të anëtarësimit në BE ishte shumë e sofistikuar dhe e pa precedent, dhe u tregua se Berlioni nuk kishte zhvilluar një plan gjithpërfshirës për një proces afatgjatë. Çështja e njohjes së Kosovës si shtet i pavarur zyrtarisht nga Serbia si parakusht për anëtarësimin në BE mbeti e hapur. Gjermania dhe aleatët Perëndimor i lejuan Beogradit që të vendos se sa nga e vërteta e hidhur është e gatshme të ndajë me qytetarët e saj dhe me Serbët e Kosovës. Obligimi i dytë sfidues për Beogradin ishte që të bëjë presion tek serbët e veriut të Kosovës, të cilët i kishte manipuluar për më shumë se tri dekada, të votojnë në zgjedhjet e Kosovës. Në një mjedis ku rendi dhe rregullat janë inekzistente, siç është rasti me veriun e Kosovës, e ku institucionet Perëndimore si KFOR e EULEX asnjëherë nuk kishin mundur të ushtrojnë kontroll të plotë, Perëndimi është mbështetur te Beogradi për organizimin e zgjedhjeve, duke e kthyer kështu Serbinë brenda Kosovës. Në anën tjetër, Kryeministri i Serbisë Aleksandar Vučić, e delegoi këtë obligim te Aleksandar Vulin, shef i zyrës së qeverisë për Kosovën, i cili ishte në krye të një partie serbe në Kosovë dhe ndiqte interesin e tij personal përgjatë zbatimit të detyrave të ngarkuara nga Qeveria Serbe.

Këto rrethana të reja rezultuan me (ri) kthimin e Beogradit me rol dominant mbi politikën e Serbëve në tërë Kosovën, jovetëm në veri, duke bërë që qytetarët Serb të Kosovës të hutohen nga ndryshimi i

<sup>20</sup> Intervista me diplomatët e BE dhe SHBA, përfaqësues të partive politike dhe analistë. Prishtinë, 2014-15; Intervista me zyrtarë të qeverisë Gjermane dhe diplomatë europian. Berlin, Nëntor, 2014.

qëndrimeve të Beogradit në prag të zgjedhjeve. Beogradi shkarkoi kryetarët e katër komunave me shumicë serbe në veri për shkak të rezistencës së tyre ndaj marrëveshjes së Prillit, dhe u bëri thirrje qytetarëve Serb që të votojnë për institucione Serbe që për herë të parë do të kenë njohje ndërkombëtare, duke i siguruar që, ashtu siç parashihet me marrëveshjen e Prillit, do të krijojnë Asociacionin e Komunave Serbe si entitet autonom i ngjashëm me Republikën Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Beogradi arriti të krijoj një listë të përbashkët të kandidatëve Serb, të emërtuar Lista Serbe. Perëndimi kundërshtoi idenë e Beogradit që të shpërbente partitë e shumta Serbe, por as Gjermania as shtetet tjera nuk bënë përpjekje serioze për të ndaluar krijimin e *de fakto* sistemit një partiak etnik Serb. Lista Serbe i shërbeu Beogradit si instrument për të kthyer pushtetin në gjashtë komunat me shumicë serbe të pjesës jugore të vendit. Në këto komuna qytetarët tashmë ishin mësuar me realitetin në Kosovën e pavarur, por shërbimi paralel shëndetësor dhe arsimor si dhe strukturat tjera paralele Serbe ofronin shumë vende pune, për këto rajone që ishin në depresion ekonomik. Në këto vende, Beogradi u tha qytetarëve se “Serbia është kthyer”.

Në ditën e zgjedhjeve, me 3 Nëntor, Lista Serbe arriti sukses të plotë. Lista Serbe fitoi në katër komunat serbe, ndërkohë që disa sulme me bomba dhe incidente të tjerë frikësuan qytetarët dhe nuk lejuan subjektet tjera politike serbe që të zhvillojnë si duhet fushatën, kurse në ditën e zgjedhjeve ekstremistë nga rajoni dhe Serbia penguan shumë qytetarë Serbë që të votojnë. Në pjesën jugore të vendit Lista Serbe hyri në garë me zyrtarët e strukturave paralele Serbe, të cilët arritën të fitojnë pesë nga gjashtë komunat me shumicë Serbe, përmes një fushate të gjerë në të cilën morën pjesë edhe zyrtarë të Qeverisë Serbe, kërcënime me humbje të vendeve të punës në institucionet Serbe, duke siguruar fitoren e kandidatëve të saj me votat e Serbëve të Kosovës që jetojnë në Serbi, dhe duke siguruar me sukses një numër të konsiderueshëm të votave nga këta qytetarë Serbë të Kosovës që aktualisht jetojnë si refugjat në Serbi, e të cilët në masë të madhe varen nga ndihmat sociale që u ofron shteti Serb. Dalja në zgjedhje në komunat veriore ishte mes 18% dhe 31%, e që ishte konsideruar si shumë e ulët kur kemi parasysh se rreth 10% të votave në disa komuna konsiderohet se kanë ardhur nga Serbët që jetojnë jashtë Kosovës. Tri ditë pas zgjedhjeve votimi është përsëritur në në tri qendra të votimit në Mitrovicën e Veriut pasi persona të maskuar kanë bastisur qendrën e votimit duke detyruar OSBE-në që të tërheq stafin e saj nga veriu i Kosovës dhe të mbyll qendrat e votimit. Megjithatë, pas rivotimit të pjesshëm OSBE deklaroi se zgjedhjet kanë qenë të rregullta, ndoshta me qëllim që të mos komplikojnë edhe më tepër zbatimin edhe ashtu të vonuar të marrëveshjes së Prillit. Ambasadori Jean-Claude Schlumberger, Kreu i Misionit të OSBE në Kosovë, deklaroi se “zgjedhjet e suksesshme në veri kanë hapur rrugën për proceset e mëturshme demokratike në Kosovë”.<sup>21</sup>

Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në komunat me shumicë Serbe, me 8 Qershor 2014, iu kushtua shumë më pak vëmendje nga ana e komunitetit ndërkombëtar, edhe pse ato u organizuan dhe mbajtën ngjashëm me zgjedhjet lokale të një viti më parë. Beogradi sërish krijoi huti tek votuesit Serb. Fillimisht zyrtarët e Qeverisë Serbe ofruan mbështetje për katër kryetarët e komunave të cilët avokonin për bojkotim të zgjedhjeve, ndërkohë që më vonë gjatë fushatës qëndrimi i tyre ndryshoi pas një takimi të

<sup>21</sup> Intervista me politikanë, gazetarë dhe analistë Serb, Kosovë, 2013; *Ende nuk është punë e kryer. Kosova dhe marrëveshja Prishtinë-Beograd*. Analizë Politike e DPC. Berlin, Nëntor 2013, f. 3-5; Të dhëna nga Komisioni Qendror I Zgjedhjeve (KQZ); “OSBE fasilitoi me sukses zgjedhjet në katër komunat e veriut të Kosovës”. Mund ta gjeni në: <http://www.osce.org/kosovo/109098>

mëvonshëm të kryetarëve të katër komunave veriore dhe drejtorin e Qeverisë Serbe për Kosovën dhe Metohinë, Marko Đurić. Dalja në zgjedhje ishte stabile dhe varionte nga 18% në Mitrovicën e Veriut deri në 36% në Zubin Potok. Lista Serbe arriti të fitoj 9 nga 10 vendet e rezervuara në Kuvend për minoritetin Serb në Kosovë.<sup>22</sup> Kjo e vulosi fatin e Partisë Liberale Serbe (SLS), subjekt ky i Serbëve të jugut i mbështetur nga Perëndimi, e që kishte rol dominant në skenën politike dhe kishte qenë pjesëmarrës në qeverisje që nga viti 2008. Me krijimin e koalicionit të madh në vitin 2014, Lista Sërbe e zuri vendin e SLS në Qeverinë e Kosovës. Raportet për manipulime në shkallë të gjerë gjatë zgjedhjeve nga ana e Listës Serbe, të mbështetur nga Beogradi, kishte shumë më pak ndikim te ndërkombëtarët në krahasim me zgjedhjet e Nëntorit. Siç insistonte një bashkëbisedues Serb “në disa qendra të votimit në veri ka pasur manipulime me fletëvotime”. Një burim tjetër mbështetste këtë pohim duke theksuar se “natyrisht zgjedhjet nuk kanë qenë të drejta ngase janë manipuluar duke sjellur katër apo pesë mijë vota nga Beogradi, dhe kaq mjaftonte”. Perëndimi, diplomatët dhe organizatat tjera ndërkombëtare vetëm e kthyen kokën anash. Kur gjatë një takimi privat me ambasadorin e njërit prej shteteve anëtare të BE-së i ngrita këto çështje, ai lëri të nënkuptohej se kisha të drejtë.”<sup>23</sup>

#### *Marrëveshja e Brukselit dhe Asociacioni/Bashkësia e Komunave Serbe*

Në fillim të vitit 2015, pasi u konsoliduan qeveritë e reja në Beograd dhe Prishtinë and Përfaqësuesja e Lartë e BE-së Federica Mogherini u sistemua në postin e saj, BE mund të vazhdonte dialogun nga ku kishte mbetur një vit më parë. Pas finalizimit të marrëveshjes për zbatimin e integritit të gjyqësorit në veri të Kosovës, erdhi në rend të ditës krijimi i Asociacionit/Bashkësisë së Komunave Serbe, si një nga qështjet madhore të marrëveshjes së Prilli, e për të cilën nuk ishte bërë asnjë lëvizje deri atëherë. Një propozim i draftit fillestar për statutin e Asociacionit ishte përgatitur nga Qeveria në fund të vitit 2013. Në ndërkohë, në fillim të vitit 2014 Beogradi prezantoi propozimin për statutin e Asociacionit, i cili mënjëherë u refuzua nga Prishtina dhe BE. Në kuadër të këtij propozimi parashihej që gjysma e pronave të Kosovës që Beogradi i konsideronte si pronë shtetërore e Serbisë të vihen në regjistrat e Asociacionit/Bashkësisë që do të krijohej.<sup>24</sup>

Në Qershor të vitit 2015, derisa po kryheshin përgatitjet për raundin e radhës të dialogut politik mbi Asociacionin e Komunave në Bruksel, ende ishte e paqartë se proceduralisht kush ishte përgjegjës për të hartuar draftin e parë të statutit, si bazë mbi të cilën do të zhvilloheshin negociatat. Por Beogradi dhe BE ishin nën presion të konsiderueshëm për faktin se Qeveria e Vučić publikisht e kishte vendosur si cak të hapjes së negociatave për kapitujt e anëtarësimit në BE gjatë vitit 2015, ndërkohë që Berlioni insistonte që edhe kapitulli 35, i cili përfshinë marrëdhëniet me Kosovën, të jetë në mesin e kapitujve. Takimi i muajit Korrik dështoi pasi Qeveria e Kosovës refuzoi të pranoj dy pozicione që ishin avancuar nga Serbia, e që parshihnin që stafi i Asociacionit të jenë shërbyes civil dhe që Asociacioni të ketë të drejtën e menaxhimit të ndërmarrjeve, me argumentin se këto do ti jepnin Asociacionit kompetenca ekzekutive. Por takimi i radhës i zhvilluar me 25 Gusht, prodhoi një marrëveshje të befasishme në mes të Prishtinës dhe Beogradit

<sup>22</sup> Të dhëna nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

<sup>23</sup> Intervista me politikanë dhe analistë Serb, Kosovë, 2013

<sup>24</sup> Intervistë me zyrtarë të BE-së në Beograd dhe Prishtinë, 2014.

mbi parimet e përgjithshme dhe elementet kryesore të Asociacionit, të cilat vendosnin kornizat mbi bazën e të cilave do të hartohej statuti. Marrëveshja ishte pasuar me interpretime kontradiktore nga palët, e që pasqyronin qëndrimet që Prishtina dhe Beogradi mbanin para arritjes së marrëveshjes. Kryeministri Vučić deklaroi se kishte arritur me sukses të ruaj kompetencat ekzekutive të Asociacionit, ndërkohë që homologu i tij nga Kosova Mustafa dhe Ministri i Punëve të Jashtme Thaçi insistonin se kanë mbrojtur sovranitetin e vendit dhe se Asociacioni do të ketë statusin e një organizate joqeveritare. Opozita në Kuvendin e Kosovës dhe segmente të shoqërisë civile në Kosovës e akuzuan qeverinë se ka pranuar krijimin e një entiteti autonom kundërkushtetues, ngjashëm me Republikën Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe paralajmëruan për rezistencë politike të fuqishme për të pamundësuar zbatimin e marrëveshjes.<sup>25</sup>

Megjithatë, asnjë nga këto interpretime nuk pasqyronin në mënyrë korrekte marrëveshjen e arritur për statutin e Asociacionit. Marrëveshja parasheh një Asociacion/Bashkësi të Komunave që nuk është OJQ e as Republika Srpska, por një zgjidhje unike, në mes të një entiteti autonom pa vazhdimësi territoriale dhe një formë klasike dhe një shkrirje vullnetare klasike e kompetencave të disa komunave pas një niveli të tretë të pushtetit në mes të nivelit qendror dhe lokal, e që mund të gjindet në shumë vende të Europës. Karakteri i Asociacionit mund të kuptohet më së miri në kontekst të procesit i cili e prodhoi marrëveshjen e 25 Prillit, pra një zgjidhje klasike afatshkurtër e BE që kishte për synim arritjen e çfarëdo kompromisi të realizueshëm, pa pasur parasysh implikimet negative në aspektin afatgjatë për demokracinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe dhjetë komunat me shumicë serbe (me përjashtim të disa vijave të kuqe të përcaktuara nga Berlioni dhe Uashingtoni). Sipas një zyrtari të BE, drafti i dokumentit i cili shërbeu si bazë për negociim në Bruksel ishte hartuar nga një jurist i EEAS i cili nuk kishte fare përvojë në fushën e qeverisjes lokale. "Me 25 Gusht negociatat tashmë kishin hyrë në fazën përmbajtësore" theksonte ai. "Drafti pësonte ndryshime vazhdimisht gjatë diskutimit në tavolinë, e që karakterizohej me fjalë kompromisi, siç ishte rasti me statusin e shërbyesve civil, gjë që mbeti e paqartë ngase në tekst thuhet vetëm "në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil".

Ngjashëm ishte çështja e pronësisë së Asociacionit mbi ndërmarrje, ku në marrëveshje flitet vetëm për "bashkëpronësi". Gjithashtu, termi "mbikëqyrje të plotë" të funksioneve në fushën e arsimit dhe shëndetësisë jo domosdoshmërisht mund të kuptohet si kompetenca ekzekutive. Pra teskti përmban shumë fraza të paqarta që lejojnë hapësirë për interpretime të ndryshme. Situata bëhet edhe më e komplikuar kur ti shtohet fakti se teksti në gjuhën Shqipe dhe Serbe dallon nga teksti në gjuhën Angleze. Prandaj, është e qartë se forma dhe karakteri i Asociacionit do të varet nga përmbajtja e statutit të tij. Gjuha e paqartë e marrëveshjes ofron një kornizë të tillë që institucionet dhe kompetencat e Asociacionit të jenë hibride shumë të mjegullta në kuptimin institucional, ligjor dhe kushtetues. Duke pasur parasysh kulturën dominuese politike dhe ligjore, kjo situatë krijon hapësirë për vendosjen e praktikave jo

<sup>25</sup> Bodo Weber, "Asociacioni i Komunave Serbe në Kosovë: nuk është as Republika Serbska as OJQ, por kompromis klasik i Brukselit". Postim në blogun e DPC. 1 Shtator, 2015, Mund ta gjeni në: [at: http://democratizationpolicy.org/the-association-of-serb-municipalities-in-kosovo---it-s-neither-a-republika-srpska-nor-an-ngo--but-r-](http://democratizationpolicy.org/the-association-of-serb-municipalities-in-kosovo---it-s-neither-a-republika-srpska-nor-an-ngo--but-r-); Intervistë me zyrtarë të BE-së, Prishtinë Qershor, 2015; shihni edhe raportin e Vetëvendosjes "Republika e Kosovës: Rezistenca ndaj regjimit gjysmë autoritar" 21 Tetor, 2015. Mund ta gjeni në: [http://www.Vetëvendosje.org/wp-content/uploads/2015/10/Report-on-Kosova\\_Movement-for-SELF-DETERMINATION.pdf](http://www.Vetëvendosje.org/wp-content/uploads/2015/10/Report-on-Kosova_Movement-for-SELF-DETERMINATION.pdf).

demokratike.<sup>26</sup>

## Këmbimi i demokracisë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit - ndikimi

Me PDK-në në pushtet për më shumë se shtatë vite dhe më Perëndimin që gjatë viteve të fundit ka vendosur Dialogun mbi të gjitha prioritetet tjera, demokracia dhe sundimi i ligjit në Kosovë kanë mbetur strukturisht të mangëta.

Edhe pse në zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014 niveli i vjedhjes së votave ishte dukshëm më i ulët në krahasim me vitin 2010,<sup>27</sup> nuk ka pasur asnjë reform sa i përket sistemit zgjedhor. Të gjitha mangësitë përmbajtësore dhe strukturore ende janë evidente, e veçanërisht:

- Mosmarrëveshjet kronike në mes të subjekteve politike në lidhje me numrin e zonave zgjedhore për të zëvendësuar sistemin me një zonë të vetme, që shpesh lë rajone të tëra pa përfaqësim në Kuvend
- Përbërja politike e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e dominuar nga partitë në pushtet (e që tani e ka edhe një anëtar të Listës Serbe, lojale ndaj Beogradit), dhe komisionet zgjedhore komunale të cilat kontrollohen nga partitë në pushtet në nivel lokal
- Menaxhimi i qendrave të votimit nga drejtorët e shkollave që pothuajse në të gjitha rastet janë figura politike
- Mos azhurnimi i listës së votuesve
- E drejta e votimit për zgjedhje lokale për qytetarët që jetojnë jashtë vendit
- Rregullat e paqarta për dokumentet që kërkohen për identifikimin e votuesve në qendrat e votimit
- Mungesa e afateve të caktuara kohore për publikimin e rezultateve zyrtare të zgjedhjeve dhe afatet e shkurtëra kohore për dorëzimin e ankesave për parregullësi gjatë zgjedhjeve

Rishtazi, pas inicimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Kosovën një delegacion i BE-së në Kosovë i mbështetur nga Këshilli i Evropës dhe OSBE morën iniciativën për rifillimin e reformës së sistemit zgjedhor, por iniciativa ishte bllokuar nga SHBA-të.

Sa i përket strukturës së brendshme dhe hierarkisë së partitë parlamentare në Kosovë vazhdojnë të mbesin autoritare. Financimi i subjekteve politike vazhdon të jetë jo transparent, me nivel të lartë të financimit “në hije”, dhe pa rregulla të cilat do të garantonin transparencë dhe mekanizma efektiv të zbatimit të tyre. Me gjithë progresin e arritur, kapacitetet e Kuvendit për të ushtruar mbikqyrje efikase të ekzekutivit ende

<sup>26</sup> “Asociacioni/Bashkësia e Komunave me shumicë Serbe në Kosovë– parimet e përgjithshme/elementet kryesore,” EEAS, Gusht, 2015. Mund ta gjeni në: [http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/150825\\_02\\_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf); Intervistë me zyrtar të BE-së. Prishtinë. Shtator, 2015.

<sup>27</sup> Deklaratë e BE për Zgjedhjet Parlamentare të 8 Qershor 2014 në Kosovë.” 12 Qershor, 2014. Mund ta gjeni në: <http://www.osce.org/pc/119958?doenload=true>.

janë të kufizuara. Në përgjithësi, Kuvendi vazhdon të funksionoj si de facto organ në shërbim të Qeverisë dhe koalicionit qeverisës, duke nxitur kështu krijimin e raportit konfliktual në mes të qeverisë dhe opozitës. Në anën tjetër funksionimi i Qeverisë së Kosovës ende nuk është i rregulluar me ligj. Administrata publike vazhdon të jetë e dominuar nga familjarizmi dhe lidhjet miqësore. Institucionet e pavarura mbikëqyrëse janë të dobëta dhe të gjeturat e rekomandimet e tyre shpesh përfundojnë pa u marrë parasysh nga Kuvendi dhe Qeveria.<sup>28</sup>

Sundimi i ligjit në Kosovë vazhdon të jetë i dobët. Gjyqësori as nuk është i pavarur e as efektiv. Gjyqtarët dhe prokurorët vendor nuk kanë zhvilluar një kulturë të pavarësisë që do ti mbronte nga ndikimi politik gjatë trajtimit të rasteve të nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërkohë që as nuk mund të flitet për krimet e luftës. Për këto raste mbrojtja e dëshmitarve është pothuajse e pamundshme brenda vendit. Politikanët e paraburgosur kanë treguar se janë në gjendje të krijojnë vetë rregullat në sistemin e qendrave të paraburgimit në Kosovë. Me mbështetjen e Perëndimit Policia e Kosovës ka ndërmarrë reforma të thella por autonomia operacionale në raport me ministrin e punëve të brendshme dhe partitë politike në pushtet nuk është arritur. Në qeverinë aktuale, ministria e punëve të brendshme vazhdon të mbetet nën kontrollin e PDK-së, edhe pse ministri i punëve të brendshme Skender Hyseni është nga radhët e LDK. Një zyrtar i LDK-së shpjegonte se “gjatë takimeve me Mustafën kur negociohej për koalicionin Thaçi insistonte që ai të zgjidhte ministrin e punëve të brendshme nga radhët e LDK. Mustafa u pajtua për këtë, dhe Thaçi insistoi që Hyseni të jetë ministër i punëve të brendshme duke siguruar kështu vazhdimin e kontrollit të policisë nga ana e PDK-së”. Në anën tjetër një sistem i dobët i gjykatave ekonomike është treguesi më i mirë që rregullat në fushën e ekonomisë janë pothuajse të pa implementueshme”.<sup>29</sup>

Vendimi i Perëndimit për të mbështetur krijimin e koalicionit të madh si mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit në këmbim të zhvillimit të demokracisë dhe forcimit të sundimit të ligjit ka filluar ti hakmirret. Qeveria e re u cilësia e dobët për faktin se në koalicionin ishin PDK dhe LDK, dy parti tradicionalisht rivale, dhe pozicioni i Mustafës si Kryeministër u dobësua, nga dominimi i Thaçit i cili u zgjodh Zv.Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme. Siç shpjegonte një analist vendor “Mustafa vetëm reagon, ai nuk vepron. PDK i udhëheq më me efikasitet ministritë e saj, për dallim nga LDK e cila ka vendosur figura anësore në postet e ministrave”. Në të njëjtën kohë, përvoja me krizën për formimin e qeverisë ka radikalizuar edhe më shumë Lëvizjen Vetëvendosje e cila gjatë bllokadës kishte treguar shenja të moderimit dhe kishin nisur kontaktet me komunitetin ndërkombëtar. Edhe AAK është bërë më radikale, duke hequr dorë nga mbështetja e dialogut dhe themelimit të Gjykatës Speciale. Siç pohonte një nga zyrtarët e lartë të kësaj partie “nëse detyrohemi nga komuniteti ndërkombëtar të fundosemi, se paku le

<sup>28</sup> Për detaje shihni ndër të tjera: *Deforma Zgjedhore. Dy vite pas reforma në pikën zero. Instituti për Demokraci dhe Zhvillim*. Prishtinë, 2013; Forcimi i shtetësisë së Kosovës përmes demokratizimit të partive politike. Analizë politike e KIPRED Nr. 2012/04, Prishtinë, Qershor 2012. Mund ta gjeni në:

<http://www.kipred.org/repository/docs/>

*Strengthening the statehood of Kosovo through the democratization of political parties\_17969.pdf*; Standardet për financimin e subjekteve politike- ballafaqimi me financimit në “hije” të subjekteve politike në Kosovë. GLPS dhe KFOS. Qershor 2014. Mund ta gjeni në: Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë. Misioni i OSBE në Kosovë. Korrik, 2012.

available at: <http://www.osce.org/kosovo/92050?doenload=true>.

<sup>29</sup> Hulumtim i kryer nga autori gjatë përgatitjes së analizës: EULEX-Drejt strategjisë së integruar dalëse. *Strengthening the rule of law through EU integration*, DPC and GLPS.



të fundosemi pa bërë kompromise”.

Në ndërkohë, konfrontimi që krijoi procesi i formimit të koalicionit qeverisës ka eskaluar në nivel të paprecedent. Protestat e organizuara nga opozita në Janar të vitit 2015, si reagim ndaj deklaratave provokative të Ministrit për Kthim të Listës Serbe, Alexander Jablanovic<sup>30</sup> rezultuan me aktet më të dhunshme që Kosova kishte përjetuar pas pavarësisë, e që lanë më shumë se 170 persona të lënduar. Më pas në përpjekje për të bllokuar impelmentimin e marrëveshjes së 25 Gushtit me Serbinë, deputetët e opozitës bllokuan për javë të tëra punën e Kuvendit të Kosovës si akt të mosbindjes civile. Situata u përshkallëzua me 8 Tetor, kur ish lideri i Vetëvendosjes deputeti Albin Kurti hodhi gaz lotsjellës në Kuvend.<sup>31</sup> Konflikti vazhdoi me hedhjen e sërishme të gazit lotsjellës në Kuvend, dhe arrestimin e anëtarëve të levizjes Vetëvendosje, si dhe përlëshjen e vazhdueshme në mes të aktivistëve të partive politike dhe policisë jashtë ndërtesës së Kuvendit të Kosovës.<sup>32</sup>

Zhvillimet politike në Kosovë gjatë viteve të fundit dhe mangësitë e vazhdueshme në zhvillimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit kanë filluar të kërcënojnë zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Ekonomia e Kosovës tashmë një kohë të gjatë ka qenë e karkterizuar me dobësi kronike dhe zhvillim të ulët. Aktivitetet ekonomike në masë të madhe janë të bazuara në burime jo të qëndrueshme siç është importi i mallrave, shpenzimet qeveritare, dhe remitancat nga diaspora. Sektori privat është i kufizuar kryesisht në tregti dhe shërbime, dhe me fare pak prodhim. Këtu përfshihet edhe sektori shumë pak i zhvilluar i Bujqësisë, edhe pse jeta e 60% të kosovarëve është e varur nga bujqësia. Kompanitë kosovare kanë një mesatare prej 6.8 të punësuarve. Me popullsinë më të re në Evropë, vendi ka shkallë jashtëzakonisht të ulët të punësimit me vetëm 25% të punësuar, me shkallë të papunësisë rreth 30% që në mesin e të rinjve arrin deri në 55 %. Rreth 34.5% e kosovarëve jetojnë në varfëri, nga të cilët 12% në varfëri ekstreme. Ekonomia vuan nga një sërë pengesash që vështirësojnë zhvillimin e bizneseve dhe investimet e huaja direkte, ku duhet theksuar gjyqësorin jofunksional dhe kompetencën jo fer, të cilët ndihmojnë ekonominë gri. Sipas anketave, fshehja e taksave është evidentuar në 34% të bizneseve që merren me shitje, dhe 27% të fuqisë së përgjithshme punëtore, e ku përfshihen 70% të fuqisë punëtore të sektorit të bujqësisë të cilët nuk raportojnë të ardhurat e tyre mujore. Të ardhurat nga remitancat të cilat përbëjnë rreth 14% të GDP dhe financojnë 40% të deficitit tregtar të vendit, luajnë rol të rëndësishëm në stabilizimin socio-ekonomik, e që nuk garantojnë qëndrueshmëri në aspektin afatgjatë. Vendi e kaloi pa dëme të mëdha krizën e fundit financiare globale falë ekonomisë së mbyllur dhe remitancave nga Gjermania dhe Zvicra, dhe faktin që borxhi i përgjithshëm publik mbetet i vogël, edhe pse ka shenja që rritja e jostabilitetit ekonomik ndërlihet me zhvillimet politike. Ashtu si në zgjedhjet e vitit 2010 kur

<sup>30</sup> Jablanović kishte ofenduar protestuesit shqiptar, në mesin e të cilëve ishin edhe familjarë viktimave të luftës, të cilët ishin mbledhur për të protestuar kundër vizitës së pelegrinëve Serb nga Beogradi në kishën ortodokse në Gjakovë, duke l qajtur “egërsira” “Egërsirat e detyrojnë Ministrin Serb të jep dorëheqje” *BIRN*, 13 Janar 13, 2015. Mund ta gjeni në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/more-calls-for-minister-resignation-over-djakovica-events>.

<sup>31</sup> Intervistë me zyrtar të AAK-së, Prishtinë, Qershor 2015; Valerie Hopkins, “Rrënjët e një kryengritje,” *Prishtina Insight*, 30 Janar – 12 Shkurt, 2015, f 5-11; “Kuvendi nën bllokadën e opozitës,” 1 Tetor, 2015, *Radio Evropa e Lirë*. Mund ta gjeni në: <http://www.slobodnaevropa.org/content/skupstina-pod-blokom-opozicije/27281470.html>; “Dënohen ashpër veprimet e opozitës në Kuvend,” 8 Tetor, 2015, *Radio Evropa E Lirë*. Mund ta gjeni në: <http://www.slobodnaevropa.org/content/kosovo-opozicija-zvizdaljkama-blokira-rad-skupstine/27294798.html>.

<sup>32</sup> „Seanca plenare mbahet pa opozitën,” *Radio Evropa e Lirë*. 29 Tetor, 2015. Mund ta gjeni në: <http://www.slobodnaevropa.org/content/opet-skupstinko-zasedanje-i-opet-suzavac/27322843.html>.

Qeveria Thaçi rriti pagat e sektorit publik nga 30-50 %, gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2014 pagat u rrigën për 25%, dhe u premtua se ato do të rriten edhe për 25% nëse partia e tij i fiton zgjedhjet. Rritja e fundit u tregua e paqëndrueshme në aspektin fiskal, dhe Qeveria Mustafa u detyrua të mos zbatoj këtë premtim parazgjedhor, duke nxitur kështu reagimin e mësuesve dhe përfituesve të tjerë të këtij sistemi të patronazhit.<sup>33</sup>

Koha e arritjes së marrëveshjes për koalicionin qeverisës coincidoi me valën e gjerë të migrimit të jashtëligjshëm të kosovarëve drejt Evropës Perëndimore, që kishte filluar më herët por që ishte në nivel më të ulët. Dhjetëra mijëra kosovarë u larguan nga vendi, në drejtim të Gjermanisë, Zvicrës dhe Austrisë, madje duke e pasur të qartë që nuk kishin asnjë gjasë për të siguruar të drejtën e azilit. Migrimi masiv filloi në vitin 2014 mënjherë pasi Serbia thjeshtoi procedurat e udhëtimit për Kosovarët, rezultat ky i marrëveshjes së prillit, duke ua mundësua kështu kosovarëve që të arrijnë lehtë kufijtë e BE-së. Vala e migrimit arriti pikën kulmore në fund të vitit. Shumë nga personat që ikën nga Kosova ishin të papunë, ndërkohë që humbja e shpresës për ndryshime politike, shoqërore dhe ekonomike konsiderohet të ketë qenë faktor tjetër me ndikim. Siç tregonin dy anketa të zhvilluara në Kosovë në fillim të vitit 2015, mungesa e shpresës për përmirësim të situatës politike dhe mungesa e besimit në institucionet e shtetit ishin dy motivet kryesore që i shtyenin njerëzit të migrojnë. Dy anketa të mëparshme të zhvilluara gjatë vitit 2014 tregonin se vetëm 25% e respondentëve ishin të kënaqur me punën e Kuvendit dhe Gjyqësorit, ndërsa vetëm 21% ishin të kënaqur me punën e Qeverisë. Një nga anketat e zhvilluara në vitin 2015, 88% e respondentëve konsideronin se përgjegjësia kryesore për valën e migrimit bie mbi qeverinë.<sup>34</sup>

Si rezultat i qëndrimeve dhe politikave të Perëndimit të cilat e vendosën zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për statusin në rend të parë, demokracia dhe qeverisja e mirë nuk janë dëmtuar askund më shumë se në komunat me shumicë serbe, veçanërisht ato në pjesën jugore të lumit Ibër. Komunat me shumicë serbe dhe politika serbe në përgjithësi tani janë nën kontrollin e Listës Serbe. Autoriteti i Beogradit, bashkë me procesin e dialogut dhe resurset administrative në Kosovë ku shteti Serb ka mbajtur rreth 300 institucione aktive tani do të forconte vullnetin e Serbëve të Kosovës. Perëndimi nuk kishte kërkuar në kuadër të marrëveshjes së Prillit që institucionet komunale të shtetit Serb në Kosovë duhet të pushojnë se ekzistuarin pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në kuadër të ligjeve të Kosovës. Për pasojë paralelizmi i institucionit thjesht mori vetëm formë tjetër. Në dhjetë komunat me shumicë Serbe, kryetarët e zgjedhur të komunave ishin të njëjtit që ishin emëruar më herët nga Beogradi si kryetar të komunave paralele Serbe, gjë që krijonte një mjedis shumë të përshtatshëm për lulëzimin e korrupsionit. Në kuadër të listës Serbe ekzistojnë dy

<sup>33</sup> *Klima për biznes në Kosovë*. Riinvest, Prishtinë, 2014. Mund ta gjeni në:

[http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Business\\_Climat\\_in\\_Kosovo1421852590.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Business_Climat_in_Kosovo1421852590.pdf); Të paguash apo jo. Perspektiva e biznesit joformal në Kosovë. Riinvest. Mund ta gjeni në:

[http://www.fes-prishtina.org/eb/media/Publications/2013/BUSINESS\\_INFORMALITY\\_ENG\\_FINAL.pdf](http://www.fes-prishtina.org/eb/media/Publications/2013/BUSINESS_INFORMALITY_ENG_FINAL.pdf); *Raport i IMF për Kosovën nr.222*, Korrik 2013, mund ta gjeni në: <https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2013/cr13222.pdf>; Zhblllokimi i potencialit të Kosovës për zhvillim: strategjitë, politikat dhe veprimet. Banka Botërore. 29 Prill, 2010, Mund ta gjeni në: <http://web.worldbank.org/archive/website01352/WEB/IMAGES/KOSOVOCE.PDF>.

<sup>34</sup> *Profili i emigrantëve të mundshëm. Cilët janë Kosovarët me gjasat më të mëdha për të migruar? Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Analizë politike Nr. 02/2015*. Mund ta gjeni në: <http://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2015/05/GLPS-Potential-Migrants-Profile-Who-are-the-Kosovars-most-willing-to-migrate.pdf>; Vështrim mbi migrimin e Kosovarëve në BE: *Migrimi si fenomen shumë dimensional. INDEP./ Qershor, 2015*. Mund ta gjeni në: [http://www.indep.info/documents/5615\\_INDEP\\_An overvieë of migrations of Kosovars into the EU Migration as a Multifaceted Phenomenon.pdf](http://www.indep.info/documents/5615_INDEP_An%20overvie%20of%20migrations%20of%20Kosovars%20into%20the%20EU%20Migration%20as%20a%20Multifaceted%20Phenomenon.pdf).

fraksione të cilat garojnë për më shumë pushtet: partia e ish koordinatorit të Qeverisë Serbe për Kosovën dhe ministrit aktual për Çështje Sociale, Alexandar Vulin, dhe Partia Progresive Serbe (SNS) në pushtet, që përfaqësohet përmes koordinatorit aktual për Kosovën, Marko Đurić. Vulin mban nën kontroll katër komunat në veri dhe resurset e tyre administrative, ndërkohë që SNS mban kontrollin mbi komunat me shumicë serbe në pjesën jugore, me mbështetjen e dy vëllezërve Veselinovic të njohur si akter kryesor të krimit të organizuar dhe kontrabandës që kontrollojnë ekonominë e nëntokës. Lufta zhvillohet për pushtet dhe kontroll, dhe jo për politikën publike apo përfaqësimin e interesave të qytetarëve serb të Kosovës. Siç tregonte një vëzhgues i zhvillimeve në terren “në pjesën veriore nuk ka të bëjë me demokracinë por me korrupsionin”. Në pjesën jugore, Partia Liberale Serbe (SLS) që dikur ishte partia kryesore u avullua me kthimin e Beogradit, dhe mbështetësit e saj në Perëndim i kanë kthyer shpinën pas më shumë se gjysmë dekadë të mbështetjes. Një politikan serb pohonte se “në pjesën jugore të Ibri, sundon një grup i njerëzve të SNS të cilat nuk janë profesionistë, por shumë të aftë për të ushtruar represion. Vetëm në Gracanicë janë larguar nga puna më shumë se 200 persona vetëm pse ishin të lidhur me partitë e gabuara. Si pasojë, tërë investimi i Perëndimit në ndërtimin e qeverisjes lokale efektive përmes projekteve që kishin për synim përmirësimin e administrimit komunal dhe shërbimeve pulike ishte shkatërruar tërësisht, me përjashtim të Štrpces ku kishte vazhdimësi sepse Kryetari i vjetër i Komunës u zgjodh sërish dhe ku baza ekonomike ishte më e fortë. Një politikan tjetër Serb e përshkruante situatën si vijon “Komuna e Graçanicës është formalisht ende funksionale, por nuk ka vazhdimësi të përpjekjeve, nuk ka mirëmbajtje dhe nuk ka infrastrukturë. Katër komunat tjera janë praktikisht jo funksionale, sepse zyrat komunale pjesën më të madhe të kohës janë të mbyllura, dhe qëndrojnë hapur nga mesdita deri në orën 2 ose 3 pasdite”<sup>35</sup>

## Konkluzionet dhe rekomandimet

Që në ditët e para të pasluftës, Kosova ka qenë e zënë në mes të dy proceseve konkurruese, atë të arritjes së transformimit në demokraci funksionale, qeverisje të mirë, sundim të ligjit dhe zhvillim socio-ekonomik në njërin anë, dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit dhe sigurimin e sovranitetit shtetëtor në anën tjetër. Kjo sfidë rezultoi me ndarjen e përgjegjësive në mes të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë dhe forcave politike vendore. Kosova ka ndryshuar shumë nga viti 1999, por këto sfida ende vazhdojnë. Me ardhjen e Gjermanisë në krye të politikave të BE-së për Kosovën në vitin 2011, mënyra në të cilën Perëndimi i është qasur këtyre sfidave ka ndryshuar rrënjësisht. BE-ja ka marrë rolin kyç në politikën e Perëndimit në Kosovë, duke zënë vendin e SHBA-ve, dhe ky ndryshim ka ndryshuar edhe qasjen ndaj procese në Kosovë, duke e bërë atë më të mprehtë dhe më pak agresive, siç edhe është evident fakti se qasja në dialogun për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit, e përmes të cilit synohet të sigurohet sovraniteti i plotë i Kosovës dhe hapja e rrugës për anëtarësimin e Serbisë në BE, është më e mprehtë, më e sofistikuar dhe më pak agresive. Kjo qasje është e paprecedent, dhe si e tillë nuk është lehtë e pranueshme për qytetarët e Kosovës.

Nga viti 2011, Perëndimi e ka vendosur dialogun si prioritet kryesor, duke e këmbyer kështu demokracinë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit, dhe atë pothuajse në çdo hap, duke filluar nga pranimi i

<sup>35</sup> Intervista me politikanë dhe analist politik Serb. 2015.

shkeljes që PDK i bëri marrëveshjes politike të garantuar nga Qeveria e SHBA-ve, e deri te mbështetja që Gjermania ofroi në krijimin e koalicionit të madh qeveritar në Nëntor të vitit 2014, që minoi themelet e demokracisë parlamentare dhe sundimit të ligjit në Kosovë. Edhe pse mund të ketë ekzistuar një justifikim racional për vënien e dialogut si prioritet kryesor në Kosovë (së paku për një periudhë të caktuar kohore), BE dhe SHBA nuk kanë bërë asgjë për rregulluar apo së paku për të kufizuar dëmet që kjo i ka shkaktuar demokracisë dhe sundimit të ligjit. Dështimi për të ndërmarrë veprime bazike që do të korrigjonin gabimet, shpjen te konkluzioni se këmbimi që Perëndimi i bëri demokracisë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit ka qenë rezultat i një lëmshi burokratik të pa menduar mirë apo mungesës së të menduarit strategjik. Zyrtarët Gjerman dhe ata të vendeve të tjera të Perëndimit ishin aq falënderues dhe të çliruar pas tejkalimit të krizës institucionale në Kosovë, sa që nuk dëshironin të mendonin për koston politike që ky proces mund të ketë. Tani, më pak se një vit nga arritja e marrëveshjes, ata po ballafaqohen me konfliktin e përshkallëzuar në mes të opozitës dhe qeverisë, e që është pasojë e këtyre proceseve, dhe po kërcënon stabilitetin dhe bllokimin e punës së Kuvendit, pa dhënë ndonjë shenjë se situata mund të përmirësohet. Për më tepër, këmbimi që perëndimi i bëri demokracisë dhe sundimit të ligjit me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit, tani rrezikon të krijoj dëme anësore të mjaftueshme për të rrezikuar të arriturat e dialogut Beograd-Prishtinë.

Për të parandaluar këtë, dhe për ta vendosur Kosovën sërish në binarët e progresit në procesin e demokratizimit dhe sundimit të ligjit, BE dhe SHBA duhet të ndërmarrin një sërë ndryshimesh në qasjen dhe politikat e tyre:

- BE dhe SHBA duhet të përmbahen nga intervenimi i drejtpërdrejt në formimin e qeverive, dhe në vend të kësaj të mbajnë qëndrime të bazuara në parimet themelore të sundimit të ligjit dhe demokracisë parlamentare. Nëse këto parime do të shkelen sërish në arritjen e marrëveshjeve për krijimin e qeverisë, atëherë BE dhe SHBA duhet të kërcënojnë me bojkotimin e qeverisë së krijuar, dhe pezullimin e proceseve integruese në BE.
- Në kuadër të kornizës së MSA-së, BE me mbështetjen e SHBA, OSBE dhe Këshillit të Evropës, duhet të inicioj proceset reformuese në sistemin zgjedhor, duke përfshirë qeverinë, partitë opozitare dhe shoqërinë civile, madje duke u bazuar në propozimet ekzistuese të sektorit të shoqërisë civile.
- BE duhet urgjentisht të zhvilloj një strategji koherente e cila maksimizon përdorimin e instrumenteve të ndryshme për promovimin e sundimit të ligjit dhe forcimin e pavarësimin e gjyqësorit. Strategjia duhet të jetë e koncentruar kryesisht në fuqizimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe shërbimit policor, në mënyrë që të trajtojnë rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe në dhënien e një roli më të rëndësishëm organizatave vendore të shoqërisë civile në promovimin e sundimit të ligjit.
- Me gjithë dallimet fundamentale në shumë politika, diplomatët e shteteve anëtare të BE dhe të SHBA duhet të nisin komunikimin me subjektin opozitar Vetëvendosje, e në veçanti SHBA duhet ti jap fund bojkotimit të kontakteve me Lëvizjen Vetëvendosje.
- FMN duhet t'ia bëjë të qartë autoriteteve kosovare së në rast se vendosin të rrisin pagat në sektorin publik para zgjedhjeve, në atë nivel sa të shkaktojnë paqëndrueshmëri fiskale, atëherë do të ndërpriten marrëveshjet ekzistuese Standby, dhe nuk do të ketë perspektivë për

marrëveshjet të tilla në të ardhmen.

- Gjermania, SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar duhet të zhvillojnë një plan gjithpërfshirës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit të Kosovës dhe sovranitetit të kufizuar përmes procesit të integritetit në BE. Plani duhet të jetë i dizajnuar nga këndvështrimi i rezultateve të pritura, respektivisht anëtarësimit të Serbisë dhe Kosovës në BE, si anëtarë të plotë dhe sovran që kanë njohje reciproke.
- Berlioni dhe Londra duhet ti qasen në mënyrë proaktive qytetarëve të Kosovës dhe elitave politike në mënyrë që tu shpjegojnë dhe të llojnë për politikën e tyre dhe ti sigurojnë ata se dialogu dhe eliminimi i strukturave paralele nuk do të hapë rrugën për asnjë formë të autonomisë territoriale për Serbët, që të në ardhmen do të mund të pakësonte sovranitetin e Kosovës.
- BE dhe SHBA duhet ti kthehen gjuhës së qartë dhe mesazheve drejt Beogradit sikur para vitit 2014, në mënyrë që të kufizojnë hapësirën manovruese të Qeverisë së Serbisë për qëndrimet publike në lidhje me karakterin neutral ndaj statusit që sipas tyre ka dialogu dhe marrëveshja e Prillit.
- BE duhet të insistoj që Statuti i Asociacionit të Komunave Serbe të jetë në kuadër të kornizës që ofrojnë ligjet e Kosovës, të jetë i bazuar në konceptin e funksioneve komunale, dhe të ketë kompetenca të definuara qartë.
- BE dhe SHBA duhet të kërkojnë nga Serbia që menjëherë të tërheq strukturat paralele të shtetit Serb nga komunat e Kosovës.
- BE dhe SHBA duhet të zhvillojnë një plan strategjik për eliminimin e nëntokës politiko-kriminale në veriun e vendit, si parakusht për demokraci dhe sundim të ligjit. Kjo nuk do të arrihet me integrimin e policisë serbe dhe gjyqësorit, të dy këto institucione që kanë qenë të kushtëzuara që të mos prekin këto çështje, por përmes vendosjes së themelit për transformim të suksesshëm. Plani duhet të jetë pjesë integrale e dialogut në të ardhmen, pasi të jetë implementuar tërësisht marrëveshja e Prillit.
- BE duhet të bëjë presion për reformua në legjislacionin që ndërlidhet me financimin e subjekteve politike, duke vënë theksin në ndalimin e financimit të subjekteve politike Serbe nga Beogradi.
- BE dhe donatorët tjerë perëndimor duhet të mbështesin organizatat e shoqërisë civile, mediat e pavarura dhe akterët tjerë social që të luftojnë represionin politik të zyrtarëve komunal të Listës Serbe në komunat me shumicë Serbe në pjesën jugore të vendit dhe të krijojnë sërish kushtet themelore për pluralizmin politik.